

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut



Raporti tremujor shkurtë 2023



Hyrje	3
I. Lëvizjet makroekonomike.....	6
1.1. Mjedisi ekonomik ndërkombëtar	6
1.2. Oferta e brendshme.....	10
1.3. Kërkesa agregate	14
<i>1.3.1. Konsumi personal.....</i>	<i>16</i>
<i>1.3.1. Konsumi publik</i>	<i>18</i>
<i>1.3.2. Konsumi i investimeve</i>	<i>18</i>
<i>1.3.3. Kërkesa neto për eksport.....</i>	<i>19</i>
1.4. Punësimi dhe pagat.....	20
1.5. Inflacioni	24
<i>1.5.1. Inflacioni aktual</i>	<i>25</i>
<i>1.5.2. Pritjet inflacioniste.....</i>	<i>29</i>
1.6. Bilanci i pagesave.....	30
<i>1.6.1. Llogaria rrjedhëse</i>	<i>31</i>
Shtojca 1: Shkëmbimi i tregtisë së jashtme të mallrave dhe lëvizja e kursit efektiv nominal dhe real të këmbimit (NEDK dhe REDK).....	32
Shtojca 2: Ndikimi i çrregullimeve të tregut të energjisë në llogarinë rrjedhëse të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore dhe të Shteteve Baltike në gjysmën e parë të vitit 2022	36
<i>1.6.2. Llogaria financiare.....</i>	<i>40</i>
<i>1.6.3. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare dhe bruto borxhi i jashtëm.....</i>	<i>42</i>
II. Politika monetare.....	45
2.1. Likuiditeti i bankave.....	49
III. Lëvizjet në tregjet financiare.....	50
3.1. Tregu ndërbankar me depozita të pasigurta	50
3.2. Tregu i letrave me vlerë shtetërore	51
3.3. Bursat.....	54
IV. Agregatët monetare dhe kreditore	55
4.1. Agregatët monetare	55
4.2. Aktivitetet kreditore.....	58
V. Financat publike.....	61

Hyrje

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2022, në kushtet e presioneve më të theksuara të çmimeve, ka vazhduar rregullimi i politikës monetare, i nisur në fund të vitit të kaluar. **Kështu, norma bazë e interesit e Bankës Popullore u rrit në tri raste, për gjithsej 1,75 p.p., me çka në fund të vitit 2022 arriti në nivelin e 4.75%.** Në përputhje me rritjen e normës bazë të interesit, u rritën edhe normat e interesit të kredisë njëditore. Gjithashtu, u rritën edhe normat e interesit për depozitat e disponueshme njëditore dhe shtatë ditore, të cilat arritën përkatësisht në 2.65% dhe 2.70%. Shtrëngimi i politikës monetare ka për qëllim stabilizimin e pritjeve inflacioniste dhe uljen e presioneve të çmimeve, të shkaktuara nga goditjet e jashtme, të pranishme për një periudhë më të gjatë. Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë masa shtesë, përmes të cilave përforcohen sinjalet monetare, ndërsa të cilat kanë për qëllim mbështetjen e mëturjes së procesit të denarizimit të ekonomisë. **Kështu, në dhjetor 2022, u bë sërish një ndryshim në instrumentin e rezervës së detyrueshme, nëpërmjet rritjes së mëtejshme të normës së rezervës së detyrueshme të bankave për detyrimet në valutë nga 18% në 19%.** Këto ndryshime janë në drejtim të stimulimit të kursimeve në monedhën vendase dhe mbështetjes së lëvizjeve të favorshme tashmë të pranishme në strukturën valutore të kursimeve, të pranishme në muajt e fundit të vitit 2022. Duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit stabil të denarit në raport me euron, ndryshimet në politikën monetare të brendshme i reflekton edhe ndryshimet në politikën monetare të Bankës Qendrore Evropiane. Gjatë kësaj periudhe u miratuan edhe masa sistematike shtesë, me qëllim të forcimit të mëtejshëm të rezistencës së sistemit bankar.

Për sa i përket mjedisit ekonomik global, shqetësimet dhe pasiguria e shkaktuar nga pushtimi rus i Ukrainës së bashku me rritjen e inflacionit, veçanërisht në fushën e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë, përkeqësojnë perspektivën për rritjen globale. Përballë sfidave historike, aktiviteti ekonomik global po tregon shenja ngadalësimi, mes ndikimeve negative ekonomike në rritje. Është evidente se lufta, kriza energjetike, inflacioni, tensionet tregtare, si dhe pandemia do të jenë çështje aktuale në vitin 2023, të cilat do të ndikojnë ndjeshëm në ekonominë globale. Në të njëjtën kohë, përballë inflacionit global që arrin nivelet më të larta të disa dekadave, bankat qendrore në mbarë botën kanë lëvizur për të rritur normat e interesit, duke shtrënguar kushtet financiare dhe duke rritur shpenzimet e huamarrjes.

Krahasimi i treguesve të fundit makroekonomikë të ekonomisë së brendshme me dinamikën e tyre të vlerësuar brenda ciklit të projeksioneve të tetorit, tregon për devijime të caktuara në disa segmente të ekonomisë. Kështu, sipas të dhënave të vlerësuara, rritja reale e PBB-së në tremujorin e tretë të vitit 2022 u ngadalësua në 2% me bazë vjetore (4% në tremujorin paraprak), e ndikuar nga efektet negative të luftës në Ukrainë mbi çmimet dhe ofertën, si dhe luhatshmëri dhe pasiguri e theksuar e kushteve të jashtme ekonomike dhe financiare. Mesatarisht, në tre tremujorët e parë të vitit 2022, ekonomia shënoi rritje reale prej 2.7%, që është afër pritjeve të projeksionit të tetorit. Përsa i përket komponentëve, rritja është nxitur nga kërkesa e brendshme, me një kontribut negativ nga neto-eksportet. **Të dhënat e disponueshme me frekuencë të lartë për aktivitetin ekonomik për momentin tregojnë për një ngadalësim të rritjes në tremujorin e fundit të vitit,** me zhvendosje më pak të favorshme si në prodhimin ashtu edhe në një pjesë të segmentit të shërbimeve, kryesisht në ndërtimtari dhe tregti me pakicë. Në nivel të vitit të plotë, skenari bazë i tetorit supozon ngadalësimin e rritjes ekonomike në 2.3% në vitin 2022, pas së cilës pritet të përshpejtohet përkatësisht në 2.6% dhe 3.6% në vitin 2023 dhe vitin 2024. Pushtimi rus i Ukrainës, i cili çoi në krizën energjetike dhe krizën e shpenzimeve të jetesës, mbetet rreziku më i madh për aktivitetin ekonomik dhe nëse efektet e pritshme të faktorëve të brendshëm mungojnë, perspektiva e rritjes për vitin 2022 dhe 2023 sipas vlerësimeve alternative mund të të jenë më pak të favorshme dhe janë përkatësisht 2% dhe 1.8%.

Në tremujorin e katërt të vitit 2022, norma vjetore e inflacionit u përshpejtua më tej, duke arritur në 19.3%. Megjithatë, inflacioni në këtë periudhë është pak më i ulët se ai i pritur për tremujorin brenda projeksionit të tetorit, dhe devijimi është i lidhur me realizimin më të ulët të

inflacionit bazë dhe të komponentit energjetik, me devijim në rritje të komponentit ushqimor. **Për tërë vitin 2022, norma vjetore e inflacionit është në përputhje me vlerësimet dhe arrin në 14.2%.** Në përgjithësi, gjatë kësaj periudhe, një kontribut më i rëndësishëm në rritje vihet re nga kategoritë e çmimeve vendase që lidhen me lëvizjet e çmimeve të produkteve primare në bursat botërore, më tej nga rritja e çmimeve me karakter rregullator, si dhe nga rikompensimi i konsumit pas pandemisë, veçanërisht për një pjesë të shërbimeve. Nga kjo rrjedh vlerësimi se presionet mbi çmimet ende rrjedhin kryesisht nga faktorë të kahut të ofertës, pa presione më të mëdha nga kërkesa. Vazhdon të theksohet pasiguria nga lëvizja e çmimeve botërore të produkteve primare dhe ndikimi i tyre në çmimet e brendshme dhe shoqërohet me luftën në Ukrainë dhe pasojat e saj ekonomike. Sipas vlerësimeve të tetorit, për vitin 2023 pritet inflacioni 8-9% dhe stabilizimi i tij në nivelin 2.4% në vitin 2024 dhe 2% në periudhën afatmesme.

Të dhënat më të fundit të disponueshme për bilancin e pagesave tregojnë për arritje më të mira në llogarinë rrjedhëse, ndërkohë që flukse hyrëse më të ulëta në llogarinë financiare, në krahasim me pritjet sipas projeksionit të tetorit. Në tremujorin e tretë, suficiti në transaksionet rrjedhëse është 0.6% ndaj PBB-së dhe është më i ulët në bazë vjetore, gjë që i detyrohet tërësisht deficitit më të lartë në shkëmbimin e mallrave me vendet e huaja. Saldoja negative tregtare lidhet kryesisht me neto-importet të energjisë, duke reflektuar pjesërisht rritjen e çmimeve të importit nën ndikimin e çmimeve të larta të shkëmbimit të energjisë, si rezultat i situatës së zgjatur ushtarake në Ukrainë. Me të njëjtin intensitet dhe në të njëjtin drejtim ka vepruar edhe rritja e saldos negative në këmbimin e kategorive joenergjetike të produkteve. Ndryshimet në komponentët e tjerë të llogarisë rrjedhëse shënuan ndryshime pozitive në baza vjetore dhe ndikuan në drejtim të përmirësimit të saldos të llogarisë rrjedhëse. Ashtu që, kontributi i suficitit të shtuar në shkëmbimin e shërbimeve me përmirësimin e arritjeve të eksportit në shumicën e kategorive të shërbimeve, si dhe rritja e neto-flukseve nga transfertat private, me një deficit të të ardhurave parësore të pandryshuar, është i rëndësishëm. Në të njëjtën kohë, llogaria financiare regjistroi flukse neto hyrëse prej 3.8% të PBB-së, të cilat në pjesën më të madhe rezultojnë nga flukset hyrëse neto në investimet e portofolit, investimet direkte, kreditë dhe në një masë më të vogël në kreditë tregtare. Të dhënat për rezervat valutore bruto për tremujorin e katërt janë më të mira se sa pritej sipas projeksioneve të tetorit, përkatësisht për të gjithë vitin 2022 ato shënuan rritje, kundrejt rënies së pritshme. Projeksioni i tetorit për periudhën 2023-2024 parashikon rritjen e rezervave valutore dhe mbajtjen e treguesve të mjaftueshmërisë në zonën e sigurt.

Në tremujorin e fundit të vitit 2022, aktiviteti kreditues i bankave u përshpejtua, lëvizje kjo karakteristike e tregut të kredisë drejt fundit të vitit. E analizuar nga pikëpamja sektoriale, rritja tremujore e kredisë rezulton më së shumti nga rritja e mbështetjes kreditore të sektorit të korporatave, me një rritje më të moderuar të kredisë për familjet. Në bazë vjetore, rritja e kredisë në fund të tremujorit të katërt ishte 9.4%, që përgjithësisht është në linjë me rritjen e parashikuar vjetore sipas projeksionit të tetorit (9.2%). Sa i përket burimeve të financimit, në tremujorin e katërt është vërejtur një rritje e fortë në totalin e depozitave. Rritja e bazës së depozitave në këtë periudhë është e zakonshme dhe në një pjesë lidhet me faktorë sezonalë, ndërsa në këtë tremujor kontribut shtesë kanë dhënë edhe pagesat nga shteti për përballimin e krizës energjetike dhe përkrashjen e fermerëve me subvencione. E analizuar sipas sektorëve, rritja tremujore e depozitave është kryesisht rezultat i rritjes së depozitave të ndërmarrjeve, me një kontribut solid nga rritja e depozitave të familjeve. Rritja vjetore e gjithsej depozitave në fund të dhjetorit arriti në 4.9%, që është mbi rritjen e parashikuar sipas projeksionit të tetorit (prej 3.9%). Në periudhën e ardhshme pritet që baza e depozitave të bankave të vazhdojë të rritet, duke siguruar burime të qëndrueshme për financimin e rritjes së kredisë.

Në përgjithësi, aktiviteti ekonomik vendas që nga fillimi i vitit është në përputhje me rrugën e parashikuar, ndërsa perspektivat aktuale janë në përputhje me pritjet për një ngadalësim të mëtejshëm të rritjes nën ndikimin e krizës energjetike, kufizimeve të ofertës dhe krizës së shpenzimeve të jetesës e cila imponoi një shtrëngim të kushteve financiare në kornizë globale. Rritja e çmimeve të brendshme në tremujorin e fundit të vitit është pak më e ulët se ajo e parashikuar, e




ndikuar ende nga faktorë të kahut të ofertës. Vazhdon mbështetja kreditore e ekonomisë vendase nga bankat, por më e moderuar dhe në përputhje me pritshmëritë. Pozicioni i jashtëm i ekonomisë lejon që rezervat valutore të mbahen në zonën e sigurt. Megjithatë, **pasiguria dhe rreziqet për ekonominë globale dhe të brendshme në afat të shkurtër dhe afatmesëm mbeten të theksuara, dhe lufta në Ukrainë mbetet një burim kryesor përçarjeje, veçanërisht në tregjet e energjisë dhe produkteve ushqimore.** *Banka Popullore monitoron me kujdes të dhënat dhe rreziqet makroekonomike dhe, si më parë, do të marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, për të ruajtur stabilitetin e kursit të këmbimit dhe stabilitetin afatmesëm të çmimeve.*

I. Lëvizjet makroekonomike


1.1. Mjedisi ekonomik ndërkombëtar

Në tremujorin e tretë të vitit 2022 vazhdoi ngadalësimi i rritjes së aktivitetit ekonomik global, i cili kryesisht erdhi si rezultat i pasojave të krizës globale energjetike dhe zgjatjes së luftës në Ukrainë. Eurozona, si partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, në tremujorin e tretë shënoi një rritje të ngadaltë ekonomike vjetore prej 2.3% (4.2% në tremujorin e dytë), në kushtet e një kontributi më të ulët të konsumit familjar në rritje dhe të përkeqësimit të kërkesës për neto-eksport. Në tremujorin e katërt të vitit 2022, në nivel global mund të vërehet një dinamikë pak më e moderuar e rritjes së çmimeve të konsumit. Shtrëngimi i politikës monetare në vendet e zhvilluara ka vijuar edhe në tremujorin e fundit, duke pasur pasqyrsh inflacionin e lartë dhe afatgjatë dhe parashikimet se ai do të mbetet mbi nivelin e objektivit për një periudhë të caktuar. Në bursat botërore kanë vazhduar përgjithësisht lëvizjet rënëse të çmimeve të produkteve parësore. Sipas parashikimeve të Bankës Botërore nga janari 2023, ngadalësimi i rritjes ekonomike globale parashikohet të vazhdojë edhe në vitin 2023, pas së cilës pritet të përshpejtohet. Perspektiva për rritjen globale është përkeqësuar në krahasim me pritjet e mëparshme, për shkak të shtrëngimit të harmonizuar të politikës monetare globalisht për të lehtësuar presionet inflacioniste, përkeqësimin e kushteve financiare dhe kohëzgjatja e luftës në Ukrainë.

Dinamika e ngadalësuar e rritjes së ekonomisë globale vazhdoi në tremujorin e tretë të vitit 2022, e cila përgjithësisht pasqyron pasojat e krizës globale energjetike dhe kohëzgjatjen e luftës në Ukrainë, e ndjekur nga inflacioni i lartë dhe politika monetare kufizuese, rritja e pasigurisë dhe ulja e besimit midis konsumatorëve dhe subjekteve afariste. Brenda **vendeve të zhvilluara**, dinamika të tilla ishin karakteristike për Mbretërinë e Bashkuar dhe Eurozonën, ku norma vjetore e rritjes ekonomike në tremujorin e tretë u përgjysmua në krahasim me tremujorin paraprak, përkatësisht ishte 1.9% dhe 2.3% (përkatësisht 4.0% dhe 4.2%, , në tremujorin e dytë). Kjo dinamikë vjen si pasojë e rritjes dukshëm më të ulët të konsumit privat në të dyja ekonomitë, në kushtet e rritjes së përshpejtuar të çmimeve të konsumit dhe fuqisë blerëse të zvogëluar të familjeve, e plotësuar nga përkeqësimi i kërkesës për neto-eksport në Eurozonë. Nga ana tjetër, rritja ekonomike në SHBA po stabilizohet dhe është 1.9%, ndërsa në Japoni ka një përshpejtim të lehtë të rritjes (nga 1.4% në tremujorin e dytë në 1.7%). Në grupin e **ekonomive me rritje të shpejtë**, gjithashtu, janë vërejtur lëvizje divergjente në tremujorin e tretë. Kështu, Kina arriti rritje të përshpejtuar ekonomike (3.9%), pas një ecurie të dobët në tremujorin paraprak (rritje prej 0.4%), kundrejt një ngadalësimi të ndjeshëm të aktivitetit në Indi pas rritjes dyshifrore në tremujorin e dytë (nga 14% në 5.7 %), kryesisht për shkak të konsumit më të dobët të popullsisë.





Për sa i përket vlerësimeve për rritjen globale në tremujorin e katërt të vitit 2022, vlera mesatare e indeksit global PMI në tremujorin e katërt është 48,4 (52,0 në tremujorin e dytë), duke treguar stagnim të aktivitetit global në periudhë të ardhshme. Në nivel vjetor, rënia e indeksit global PMI është më e fortë dhe arrin në 11,2%.



Sipas projeksioneve të fundit të Bankës Botërore, rritja e ekonomisë globale për vitin 2023 parashikohet në 1.7%, që paraqet një ngadalësim të mëtejshëm të rritjes dhe realizim i tretë më i dobët në tre dekadat e fundit. Në vitin 2024 parashikohet përshejtim i rritjes ekonomike globale, i projektuar në 2.7%. Këto projektimet janë rishikuar në rënie nga pritshmëritë në raportin e mëparshëm të qershorit 2022, përkatësisht për 1.3 p.p. dhe 0.3 p.p. për vitin 2023 dhe 2024. Ky rishikim është një reflektim i shtrëngimit të harmonizuar të politikës monetare në nivel global, me qëllim të qetësimit të presioneve inflacioniste, përkeqësimit të kushteve financiare dhe kohëzgjatjen e luftës në Ukrainë. Presionet inflacioniste pritet të zbuten gradualisht gjatë vitit 2023, por inflacioni bazë do të mbetet në një nivel relativisht të lartë për një periudhë më të gjatë. Rreziqet për rritjen e projektuar globale janë në rënie. Me inflacion të lartë dhe goditje negative të njëpasnjëshme në kahun e ofertës, ekziston një pasiguri e konsiderueshme lidhur me ndikimin e politikës monetare në aktivitetin ekonomik në vëllim dhe në periudhën kohore. Në kushtet e rritjes së dobët ekonomike globale, kombinimi i shtrëngimit më të fortë të politikës monetare dhe problemeve financiare globale mund të rezultojë në një recesion global në vitin 2023. Rreziqe shtesë për rritjen globale lindin nga rritja e mundshme më e dobët e aktivitetit në Kinë, e

lidhur me ndërprerjet e shkaktuara nga pandemia dhe kriza në sektorin e patundshmërive, nga rritja e tensioneve gjeopolitike dhe fragmentimi i tregtisë globale, si dhe nga ndryshimet klimatike.¹

Presionet inflacioniste në nivel global u intensifikuan me dinamikë disi më të moderuar në tremujorin e katërt të vitit 2022. Megjithatë inflacioni global mbetet akoma i lartë, duket se ka arritur kulmin, duke pasur parasysh trajektoren rënëse në muajt e fundit të vitit. Nga grupi i vendeve të zhvilluara, në tremujorin e katërt në Eurozonë dhe në Mbretërinë e Bashkuar, inflacioni arriti mesatarisht përkatësisht 10.0% dhe 9.4%. Megjithatë, shikuar sipas muajve, pas arritjes së kulmit në tetor, inflacioni vërehet se po ngadalësohet në këto ekonomi. Në SHBA, rritja e çmimeve vazhdoi me një ritëm më të ngadaltë (7.1%) në tremujorin e katërt. Kjo rrugë e ndryshme rrjedh kryesisht nga përbërja e inflacionit, duke pasur parasysh se përbërësit e energjisë dhe ushqimit përbëjnë dy të tretat e inflacionit total në Eurozonë dhe rreth një të tretën në SHBA-në.



Eurozona, si partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, shënoi një rritje të aktivitetit ekonomik prej 2.3% në tremujorin e tretë, pas rritjes prej 4.2% në tremujorin e dytë. Ngadalësimi i rritjes ekonomike rezulton nga zvogëlimi i kontributit të konsumit të familjeve në rritje dhe nga përkeqësimi i kërkesës për neto-eksport, në kushtet e rritjes së përshpejtuar të importeve të nxitur nga rritja më dinamike e investimeve. Sipas projeksioneve të dhjetorit të BQE-së, për vitin 2022 pritet një rritje ekonomike prej 3.4%, që paraqet një rishikim në rritje krahasuar me parashikimet e shtatorit, ndërkohë që është bërë korrigjim në rënie për rritjen në vitin 2023 dhe pritet të arrijë në 0.5%. Në periudhën afatmesme pritet rikuperim, me një normë të projektuar përkatësisht prej 1.9% dhe 1.8% në vitin 2024 dhe 2025². Për sa i përket tregut të punës, shkalla e papunësisë në Eurozonë ka vijuar të ulet dhe në periudhën tetor-nëntor ka qenë në nivelin më të ulët historik prej 6.5%. Norma e inflacionit në tremujorin e katërt të vitit 2022 u përshpejtua në 10.0% (9.3% në tremujorin paraprak), si rezultat i rritjes më të fortë të çmimeve në komponentin e ushqimeve dhe inflacionit bazë, të kompensuar pjesërisht nga ngadalësimi, por gjithsesi i lartë i rritjes së çmimeve të energjisë. Sipas projeksioneve të dhjetorit të BQE-së, pas rritjes së fortë të çmimeve në eurozonë në vitin 2022, inflacioni parashikohet të ngadalësohet gradualisht përkatësisht në 6.3% dhe 3.4% në vitin 2023 dhe 2024, i cili më pas do të ulet në 2,3% në vitin 2025, një vit më vonë se projeksionet e shtatorit, gjatë një rishikimi në rritje për periudhën 2023-2024³.



Në tremujorin e katërt të vitit 2022, vendet e zhvilluara vazhduan të shtrëngonin politikën monetare, mes presioneve ende të forta të çmimeve. Kështu, FED rriti dy herë normën e interesit referencë, me 0.75 p.p. në nëntor dhe me 0.5 p.p. në muajin dhjetor, me çka ajo lëviz në intervalin 4.25% deri në 4.5%. Përveç kësaj, FED vendosi të vazhdojë me uljen e portofolit të saj të letrave me vlerë të kasafortës dhe hipotekave. Banka e Anglisë gjithashtu rriti dy herë normën

¹ Analiza në këtë pjesë bazohet në raportin e Bankës Botërore "Perspektivat Ekonomike Globale", botuar në janar 2023.

² Në shtator 2022, rritja reale e PBB-së në eurozonë ishte projektuar në 3.1% në vitin 2022, 0.9% në vitin 2023 dhe 1.9% në vitin 2024.

³ Në shtator 2022, inflacioni në eurozonë ishte projektuar në 8.1% në vitin 2022, 5.5% në vitin 2023 dhe 2.3% në vitin 2024.

bazë të interesit dhe në të njëjtën masë si FED në nëntor dhe dhjetor, ashtu që ajo arriti në 3.5%. Në mënyrë plotësuese, gjatë tremujorit të katërt është zbatuar programi i shitjes së aktiveve duke zvogëluar portofolin e letrave me vlerë në bilancin e bankës qendrore. BQE, pas rritjes fillestare të normave të interesit në tremujorin e tretë, ka vijuar procesin e normalizimit të politikës monetare gjatë tremujorit të katërt. Kështu, në tetor BQE rriti tre normat bazë të interesit me 0,75 p.p. dhe në dhjetor me 0,5 p.p. shtesë, kështu që norma e interesit për operacionet bazë të rifinancimit, për kreditë e disponueshme njëditore dhe për depozitat e disponueshme u pozicionua në nivelin përkatësist 2,5. %, 2.75% dhe 2.0%. Madje, BQE do të vazhdojë me riinvestimin e letrave me vlerë të maturuara në kuadër të Programit për blerjen e mjeteve deri në fund të shkurtit 2023, pas së cilës parashikohet zvogëlimi i portofolit në përputhje me dinamikën e përcaktuar.



Në tremujorin e katërt të vitit 2022, vlera e dollarit amerikan ndaj euros u nënçmua me 1.2% krahasuar me tremujorin e mëparshëm, pas mbiçmimit të vazhdueshëm prej më shumë se një viti. Mbiçmimi i dollarit amerikan reflekton pritshmëritë e investitorëve se intensiteti i rritjes së normës referencë të interesit në SHBA mund të ngadalësohet dhe politika monetare mund të ndryshojë drejtimin e saj më herët se sa pritej. Në bazë vjetore, vlera e dollarit amerikan kundrejt euros u rrit me 12.2%, mesatarisht 0.98 euro në tremujorin e katërt.

Në tremujorin e katërt të vitit 2022, përgjithësisht kanë vazhduar lëvizjet rënëse të çmimeve të produkteve primare në bursat botërore. Kështu, çmimi i naftës shënoi një rënie prej 10.2% krahasuar me tremujorin paraprak, ashtu që çmimi mesatar ishte 87.2 euro për fuçi. Rënia e çmimit të naftës është një reflektim i kërkesës së ulur për naftë mes ngadalësimit të rritjes së aktivitetit ekonomik global dhe kufizimeve në Kinë lidhur me Covid-19. I analizuar në bazë vjetore, çmimi i naftës në këtë periudhë shënoi rritje prej 25.0%, e cila pjesërisht i detyrohet bazës së ulët krahasuese. Në çmimet e produkteve primare joenergjetike⁴ (të shprehura në euro), rënia në tremujorin e katërt ishte 1.7% krahasuar me tremujorin paraprak. Shikuar sipas grupeve të produkteve, indekset e çmimeve të metaleve⁵ dhe ushqimeve⁶ shënuan rënie përkatësisht me 1,0% dhe 1,6%.


⁴ Ky indeks agregat përfshin indeksin e metaleve të çmuara, indeksin e ushqimeve dhe pijeve, indeksin e mallrave bujqësore dhe indeksin e metaleve bazë.

⁵ Në këtë indeks përfshihen metalet e mëposhtme: alumini, kobalti, bakri, hekuri, plumbi, molibdeni, nikeli, kallaji, uraniumi dhe zinku.

⁶ Në këtë indeks përfshihen këto produkte ushqimore primare: drithërat, vaji vegjetal, mishi, ushqimet e detit, sheqeri dhe ushqimet e tjera.




Çmimi i naftës së papërpunuar




Burimi: FMN-ja, baza mujore e të dhënave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Çmimet e ushqimit dhe të metaleve




Burimi: FMN-ja, baza mujore e të dhënave dhe llogaritjet e

Në raport me vendet e rajonit, rritja e aktivitetit ekonomik ka vijuar edhe në tremujorin e tretë të vitit 2022, me rritje të intensifikuara vetëm në Shqipëri, ndërsa në Kosovë rritja vërehet pas rënies minimale në tremujorin paraprak, e cila është kryesisht rezultat i arritjeve më të mira në investime. **Përsa i përket inflacionit, në vendet e analizuara të rajonit, në tremujorin e katërt të vitit 2022, vërehen lëvizje divergjente në raport me dinamikën e tij,** , përkatësisht ka rritje të përshpejtuar në Serbi, Kroaci dhe Rumani, stabilizim dhe nivel njëshifror i inflacionit në Shqipëri, ndërsa prirje rënëse vihet re në Kosovë dhe Bullgari, krahasuar me tremujorin paraprak.

Rritja reale e PBB-së në vendet e rajonit
(ndryshimet në përqindje vjetore, të dhëna tremujore)

Burimi: Eurostat.

Normat e inflacionit në vendet e rajonit
(ndryshime mesatare vjetore)

Burimi: Eurostat dhe regjistrat statistikore kombëtare.

1.2. Oferta e brendshme

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, aktiviteti në ekonominë e brendshme shënoi një rritje reale prej 2% me bazë vjetore, që paraqet një ngadalësim në raport me rritjen prej 4% në tremujorin paraprak. Në këtë periudhë dolën në pah efektet e pafavorshme të krizës energjetike dhe rritja e shpenzimeve në sektorë të caktuar të ekonomisë, gjë që solli ngadalësimin e rritjes ekonomike. Këto efekte shkaktuan një rënie të prodhimit industrial, në radhë të parë në segmentet më intensive energjetike (industria e metaleve dhe nxjerrja e xehes metalike), ndërsa në mënyrë plotësuese edhe përmes thellimit të rënies në



ndërtimari. Në të njëjtën kohë, forcoi rimëkëmbjen e sektorit të shërbimeve (tregti, transport dhe hotelieri) performanca e të cilit në të njëjtën periudhë të vitit 2021 ishte më e dobët për shkak të pandemisë COVID-19, kur ishin në fuqi kufizimet dhe kushtet më të rrepta të udhëtimit. Nga ana tjetër, të dhënat e frekuencës së lartë për kahun e ofertës që disponohen për periudhën tetor-nëntor 2022 tregojnë për një ngadalësim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik në tremujorin e fundit të vitit. Vlerësimet e drejtuesve për gjendjen e biznesit të ndërmarrjeve për tremujorin e katërt 2022, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, janë më të dobëta në të gjithë sektorët e rëndësishëm të ekonomisë, me përjashtim të sektorit të shërbimeve ku janë më të favorshëm. Për sa i përket pritjeve për periudhën e ardhshme, ato janë pak më të favorshme vetëm për industrinë përpunuese, ndërsa për pjesën tjetër të aktiviteteve pritshmëritë janë më pak të favorshme.

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, rritja reale e ekonomisë vendase ishte 2% me bazë vjetore, që paraqet një ngadalësim krahasuar me rritjen prej 4% në tremujorin paraprak (me një rënie tremujore prej 1.7 %, e rregulluar sezonalisht). Nga pikëpamja strukturore, rritja në tremujorin e tretë i detyrohet kryesisht kontributit pozitiv të grupit të aktiviteteve "tregti, transport dhe hotelieri", të cilat ishin një nga aktivitetet më të prekura nga kriza e shkaktuar nga Covid-19. Një kontribut pozitiv shtesë kanë aktivitetet që lidhen me pronën e patundshme, artin, bujqësinë, veprimtaritë financiare dhe veprimtaritë e sigurimit, si dhe "veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike". veprimtaritë e shërbimit administrativ dhe ndihmës". Nga ana tjetër, një kontribut negativ më i theksuar vihet re nga industria dhe ndërtimtaria nën ndikimin e efekteve të pafavorshme të krizës energjetike dhe rritjes së shpenzimeve, si dhe kontribut negativ ka edhe aktiviteti "administrata publike dhe mbrojtja; arsimi; shëndetësia dhe mbrojtja sociale".

PBB dhe komponentët - normat e rritjes vjetore (në %)

	norma vjetore të rritjes, në %*																
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ka.1 2020	Ka.2 2020	Ka.3 2020	Ka.4 2020	Ka.1 2021	Ka.2 2021	Ka.3 2021	Ka.4 2021	Ka.1 2022	Ka.2 2022	Ka.3 2022
Bujqësia	-0.4	-12.5	8.3	0.1	2.5	-5.2	4.0	5.4	6.1	-3.4	-1.7	-5.7	-3.6	-8.5	1.6	4.3	3.5
Industria	-3.0	1.4	5.3	1.4	-6.7	0.9	-4.7	-23.9	-5.1	7.0	-6.5	10.9	-0.7	1.3	-4.1	0.7	-1.7
nga të cilat te industria përpunimit	-1.5	1.6	6.2	2.6	-4.8	7.9	-1.4	-26.9	-1.9	11.2	0.3	23.6	5.7	5.5	-2.5	1.9	-2.9
Ndërtimtaria	-2.8	1.6	-11.0	5.5	-4.0	-5.5	1.6	-14.5	1.6	-3.8	0.8	-3.6	-3.7	-11.0	-16.7	-1.0	-9.1
Tregtia, transporti dhe komunikacioni dhe hotelieria	8.7	7.1	5.0	6.7	-10.6	4.3	-1.0	-30.2	-6.2	-4.8	-11.2	31.5	2.7	1.1	7.4	6.4	9.1
Informacione dhe komunikime	7.2	7.6	-4.1	6.8	4.5	15.9	11.9	-3.7	5.0	5.2	10.7	21.4	13.6	18.0	6.6	7.3	-0.7
Ndërmjetësim financiar	1.5	1.9	2.6	0.4	-0.1	-0.9	2.1	-4.6	0.5	1.7	-1.5	2.5	-4.2	-0.1	1.0	-0.7	5.8
Veprimtari e lidhur me patundshmëritë	-3.2	-1.6	0.1	0.2	1.1	8.3	3.5	-2.7	-1.0	4.6	6.1	9.5	7.8	9.9	4.7	7.2	3.1
Veprimtari administrative dhe shërbime ndihmëse	11.5	8.8	7.9	8.0	-8.7	15.4	-8.1	-11.3	-11.1	-4.2	7.6	17.6	19.8	17.2	17.1	12.1	5.6
Drejtoria publike	3.5	-2.2	2.0	5.2	3.2	5.6	2.3	3.2	2.7	4.4	2.5	6.4	6.9	6.4	2.1	0.9	-0.9
Art, argëtim dhe rekreacion; Veprimtari tjera shërbimi	7.2	3.1	6.6	9.6	-22.6	23.5	-14.0	-23.2	-32.9	-20.0	3.1	22.8	39.9	32.2	17.7	14.2	11.8
Produkti bruto i brendshëm	2.8	1.1	2.9	3.9	-4.7	3.9	-0.3	-15.4	-4.3	1.3	0.1	14.5	1.4	1.2	2.2	4.0	2.0

*Nga njoftimi i PBB-së nga 2.12.2022

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.


PBB dhe komponentët - normat e rritjes vjetore (në %)

	kontributi në rritjen e PBB-së, në p.p.																
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ka.1 2020	Ka.2 2020	Ka.3 2020	Ka.4 2020	Ka.1 2021	Ka.2 2021	Ka.3 2021	Ka.4 2021	Ka.1 2022	Ka.2 2022	Ka.3 2022
Bujqësia	0.0	-1.1	0.7	0.0	0.2	-0.4	0.3	0.4	0.5	-0.3	-0.1	-0.5	-0.4	-0.8	0.2	0.3	0.2
Industria	-0.5	0.2	0.9	0.3	-1.2	0.2	-0.9	-4.4	-0.9	1.2	-1.1	1.8	-0.1	0.2	-0.7	0.1	-0.3
nga të cilat te industria përpunimit	-0.2	0.2	0.8	0.3	-0.6	1.1	-0.2	-3.7	-0.3	1.5	0.0	2.8	0.8	0.8	-0.3	0.3	-0.4
Ndërtimtaria	-0.2	0.1	-0.7	0.3	-0.2	-0.3	0.0	-0.8	0.1	-0.2	0.1	-0.1	-0.3	-0.8	-0.8	-0.1	-0.5
Tregtia, transporti dhe komunikacioni dhe hotelieria	1.6	1.3	1.0	1.3	-2.1	0.8	-0.2	-6.1	-1.2	-1.0	-2.3	5.3	0.6	0.2	1.4	1.2	1.8
Informacione dhe komunikime	0.2	0.2	-0.1	0.2	0.2	0.6	0.4	-0.1	0.2	0.2	0.4	0.9	0.5	0.7	0.3	0.3	0.0
Ndërmjetësim financiar	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.2
Veprimtari e lidhur me patundshmëritë	-0.4	-0.2	0.0	0.0	0.1	0.9	0.4	-0.3	-0.1	0.4	0.7	1.1	0.8	0.9	0.5	0.8	0.3
Veprimtari administrative dhe shërbime ndihmëse	0.4	0.3	0.3	0.3	-0.3	0.6	-0.3	-0.4	-0.4	-0.1	0.3	0.7	0.7	0.6	0.7	0.5	0.2
Drejtoria publike	0.4	-0.3	0.2	0.6	0.4	0.7	0.3	0.4	0.3	0.5	0.4	1.0	0.9	0.7	0.3	0.1	-0.1
Art, argëtim dhe rekreacion; Veprimtari tjera shërbimi	0.2	0.1	0.2	0.3	-0.7	0.6	-0.4	-0.7	-1.0	-0.5	0.1	0.7	0.9	0.7	0.5	0.4	0.3
Produkti bruto i brendshëm	2.8	1.1	2.9	3.9	-4.7	3.9	-0.3	-15.4	-4.3	1.3	0.1	14.5	1.4	1.2	2.2	4.0	2.0


*Nga njoftimi i PBB-së nga 2.12.2022

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

Analizuar nga të dhënat me frekuencë të lartë, **në tremujorin e tretë të vitit, qarkullimi në tregti shënoi një rritje të vogël reale me bazë vjetore**, në kushtet e rritjes së tregtisë me pakicë dhe tregtisë së automjeteve, ndërsa tregtia me shumicë shënoi rënie. Nga ana tjetër, në periudhën tetor-nëntor 2022, qarkullimi i përgjithshëm në tregti shënoi rënie reale si pasojë e rënies së tregtisë me pakicë dhe shumicë, ndërsa tregtia e automjeteve shënoi rritje të lartë. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e “tregtisë me pakicë” për situatën e biznesit gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022 janë më pak të favorshme krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit paraprak, si dhe më pak të favorshme janë edhe pritjet për periudhën e ardhshme.




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.




Burimi: Anketa e KE-së për tregtinë me pakicë, Enti Shtetëror i Statistikës dhe Ilogaritjet e BPRMV-

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, **transporti** po shënon përgjithësisht arritje të favorshme, në kushte të rritjes së lartë në të gjitha llojet e trafikut të pasagjerëve, si dhe në trafikun rrugor të mallrave. Arritjet më të mira në trafikun e pasagjerëve janë reflektim i lëvizshmërisë më të madhe të popullsisë në ndryshim nga viti i kaluar, si rezultat i masave më pak kufizuese për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Nga ana tjetër, ka pasur rënie në transportin hekurudhor dhe atë ajror të mallrave.




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.


Në kuadër të **sektorit të hotelierisë**, në tremujorin e tretë 2022, ka vijuar rritja reale e lartë edhe pse e moderuar në bazë vjetore e numrit të turistëve, butjeve, si dhe e qarkullimit total, me një bazë krahasuese ende të ulët. Madje, në numrin e turistëve dhe butjeve, rritja vjen si pasojë e rritjes së lartë të numrit dhe butjeve të turistëve të huaj, por edhe vendas, në kushtet e rritjes së udhëtimeve me masa më pak kufizuese lidhur me pandeminë, ndërsa te numri i butjeve të turistëve vendas ka shënuar rënie të vogël. Në tetor edhe më tej shënohe ritme të larta rritjeje vjetore në numrin e përgjithshëm të turistëve, butjet dhe qarkullimi total, por me dinamikë dukshëm më të fuqishëm krahasuar me rritjen në tremujorin paraprak. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e shërbimeve për gjendjen e tyre të biznesit në tremujorin e katërt të vitit 2022 janë më pak të favorshme krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, si dhe pritjet për periudhën e ardhshme për sa i përket kërkesës janë më pak të favorshme



Në tremujorin e tretë të vitit, prodhimi industrial⁷ shënoi një rritje reale të aktivitetit prej 1,8% në bazë vjetore (rritje prej 1.3% në tremujorin paraprak), si rezultat i kontributeve negative të minierave dhe sektori energjetik, ndërsa industria përpunuese ka shënuar kontribut pozitiv. Duke parë aktivitetet, kontributi më i madh negativ vërehet në disa nga aktivitetet tradicionale, kryesisht në ato me intensive energjetike, si prodhimi i metaleve dhe produkteve metalike të fabrikuar, si dhe në prodhimin e produkteve të duhanit dhe prodhimin e produkte ushqimore. Nga ana tjetër, kontributin më të rëndësishëm pozitiv e japin disa nga aktivitetet ku janë aktive kapacitete më të mëdha eksporti të huaja, si prodhimi i makinerive dhe pajisjeve, prodhimi i mjeteve motorike dhe prodhimi i pajisjeve elektrike, ndërsa tek veprimtaritë shërbyese një kontribut më të rëndësishëm pozitiv ka prodhimi i tekstilit . Në periudhën tetor-nëntor 2022 prodhimi industrial shënoi një rënie prej 4.4%, më e thellë se rënia në tremujorin paraprak, si pasojë e kontributeve negative të industrisë përpunuese dhe minierave, ndërkohë që sektori i energjisë ka një kontribut të vogël pozitiv. Udhëheqësit e sektorit industrial kanë vlerësime më pak të favorshme për situatën e biznesit në tremujorin e katërt të vitit 2022 krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, ndërsa pritjet për lëvizjen e prodhimit në periudhën e ardhshme janë gjithashtu disi më pak të favorshme.

⁷ Analiza e lëvizjeve në industri është bërë në bazë të të dhënave mujore për indekset e prodhimit industrial të ESHS-së.


Kontributet e veprimtarive të zgjedhura ndaj ndryshimit vjetor të prodhimit industrial (në pikë përqindje)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe BPRMV-ja.

Sipas të dhënave të disponueshme me frekuencë të lartë, në tremujorin e tretë të vitit, **aktiviteti në sektorin e ndërtimit shënoi një rënie dukshëm të thellë reale me bazë vjetore**. Në të njëjtën kohë, rënia në totalin e punëve ndërtimore të kryera është tërësisht rezultat i rënies së ndërtimeve të ulëta, ashtu edhe të ndërtimit të larta. Rënia e ndërtimitarisë mund të lidhet me zbatimin më të ngadaltë të projekteve të infrastrukturës publike të filluara dhe ndikimin e pafavorshëm të fillimit të luftës në Ukrainë, i cili shkaktoi rritje të mëtejshme të larta të çmimeve tashmë të larta të materialeve të ndërtimit dhe të inputeve të tjera. Në muajin tetor, ndërtimtaria shënoi një rënie të mëtejshme reale me bazë vjetore, në kushtet e një rënieje të lartë si në ndërtimet e ulëta, ashtu edhe në ato ndërtimet të larta. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e ndërtimit për lëvizjen e aktivitetit të tyre në tremujorin e katërt të vitit 2022 janë më pak të favorshme krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa pritet për periudhën e ardhshme janë pak më të favorshme.

Punime të përfunduara ndërtimit (kontribut ndaj rritjes reale, në p.p.)



Ndërtimtaria dhe parashikimet në ndërtimtarinë




1.3. Kërkesa agregate


Shikuar nga aspekti i kërkesës, rritja reale vjetore e PBB-së prej 2,0% në tremujorin e tretë të vitit 2022 është ende tërësisht si pasojë e kontributit pozitiv

të kërkesës së brendshme. Pavarësisht rënies së disa prej komponentëve të të ardhurave reale të disponueshme (paga reale, pensione reale), konsumi personal në tremujorin e tretë shënoi rritje, pjesërisht i mbështetur nga vazhdimësia e transfertave private. Kontribut pozitiv patën edhe bruto-investimet, të cilat vazhduan të rriteshin, por me ritme më të moderuara. Të dhënat e frekuencës së lartë tregojnë se edhe më tej, në pjesën më të madhe, investimet janë reflektim i rritjes së lartë të importeve për oferta, me kushte të pasigurta të jashtme ekonomike dhe kushte të pasigurta financiare dhe ndryshueshmëri të theksuar financiare. Eksportet janë komponenti me kontributin e vetëm pozitiv më të lartë në PBB në tremujorin e tretë të vitit 2022, të cilat vazhduan të rriten me një ritëm dyshifror. Në këto kushte, por edhe me rritje të mëtijshme të stokeve, importet vazhduan të rriten disi më fort se eksportet, kështu që komponenti i neto-eksportit pati një kontribut negativ në PBB edhe këtë tremujor.

Analiza strukturore e komponentëve të PBB-së⁸ nga këndvështrimi i kërkesës tregon se edhe në tremujorin e tretë të vitit 2022, rritja në tërësi rezultoi nga kërkesa e brendshme, ndërkohë që neto-eksporti përsëri ka pasur një kontribut negativ. Rritja në tremujorin e tretë është më e ngadaltë se rritja në tremujorin e mëparshëm. Këto arritje priten dhe ndikohen nga efektet negative të luftës në Ukrainë mbi çmimet dhe ofertën, si dhe nga ndryshueshmëria dhe pasiguria e theksuar e kushteve të jashtme ekonomike dhe financiare. Shikuar nga aspekti i komponentëve individualë, bartësi kryesor i rritjes së kërkesës së brendshme në këtë tremujor ishte konsumi personal, ndërsa rritje shënuan edhe bruto-investimet, ndërsa rënie reale në këtë tremujor shënoi edhe konsumi publik. Megjithatë, komponenti me kontributin më të lartë pozitiv në rritjen e PBB-së ishin eksportet, të cilat vazhduan të rriten këtë tremujor me një normë vjetore dyshifrore. Rritje të mëtijshme, ngjashëm me tremujorin paraprak shënuan importet, të cilat kësaj radhe ishin disi më të larta se rritja e eksporteve, kështu që, si në tre tremujorët e mëparshëm, edhe këtë tremujor neto -eksportet patën kontribut negativ në PBB.



Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritjet e BPRMV-së.



Burimi: EShS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

⁸ Ndryshimet tremujore në PBB dhe përbërësit e tij janë llogaritur nga të dhënat e rregulluara sezonale.



Normat vjetore të rritjes reale (në%)										Kontribute ndaj rritjes reale vjetore (në p.p.)**										
	2019	2020	2021	2021-Tr.1	2021-Tr.2	2021-Tr.3	2021-Tr.4	2022-Tr.1	2022-Tr.2	2022-Tr.3	2019	2020	2021	2021-Tr.1	2021-Tr.2	2021-Tr.3	2021-Tr.4	2022-Tr.1	2022-Tr.2	2022-Tr.3
Konsumi personal	3.5	-3.6	8.1	2.6	15.7	5.4	8.8	2.5	1.5	5.4	2.3	-2.3	5.3	1.7	11.1	3.5	5.5	1.7	1.0	3.6
Konsumi publik	2.5	9.8	-0.4	-4.5	0.6	0.3	1.8	2.7	-5.2	-4.7	0.4	1.4	-0.1	-0.8	0.2	0.0	0.2	0.4	-0.9	-0.7
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	8.9	-11.0	11.7	7.3	44.7	3.6	1.3	11.3	14.2	17.8	5.4	-6.8	6.8	4.3	22.4	2.2	0.7	7.6	9.6	11.9
Importi i mallrave dhe shërbimeve	10.1	-10.9	11.9	0.0	43.8	0.9	11.6	21.2	19.8	19.4	-7.3	8.3	-8.4	0.0	-26.2	-0.6	-8.5	-16.5	-15.9	-15.3
Investimet bruto	8.7	-15.0	0.9	-16.3	34.3	##	9.4	31.8	41.6	9.0	2.8	-5.2	0.3	-5.2	7.0	-3.7	3.2	9.0	10.1	2.5
Kërkesa e brendshme	4.9	-5.5	5.1	-3.5	16.8	0.1	8.2	9.5	9.0	5.0	5.5	-6.1	5.5	-4.2	18.3	-0.1	9.0	11.1	10.3	5.3
Eksporti neto*	13.7	-10.6	12.4	-19.5	41.0	-7.2	40.6	56.8	37.8	24.8	-2.0	1.4	-1.6	4.2	-3.8	1.5	-7.8	-8.8	-6.3	-3.4
Mospërputhje statistikore											0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
PBB	3.9	-4.7	3.9	0.1	14.5	1.4	1.2	2.2	4.0	2.0	3.5	-4.7	3.9	0.1	14.5	1.4	1.2	2.2	4.0	2.0

* ulja e eksportit neto tregon ngushtim të deficitit

** Kontributet sipas komponentëve nuk shtohen në PBB-në reale shkaku i mospërputhjes statistikore në shumat aktuale.

Me qëllim që të përshkruhet me normave zyrtare reale të rritjes, PBB-ja agregate përfshin mospërputhje statistikore.

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe Ilogaritjet e BPRMV-se.

1.3.1. Konsumi personal

Pas stagnimit në dy tremujorët e fundit, në tremujorin e tretë, konsumi personal shënoi rritje tremujore përkatësisht 3.1%, ndërsa në bazë vjetore rritja ishte 5.4%. Në kushtet e rritjes së pasigurisë nga konflikti ushtarak në Ukrainë dhe presioneve të intensifikuara të çmimeve, gjatë kësaj periudhe vazhduan masat ekonomike shitesë për mbrojtjen e standardit të jetesës⁹, të cilat ndoshta patën një kontribut të pjesshëm në ruajtjen e konsumit familjar. Nga aspekti i financimit të konsumit, transfertat private vijuan të shënojnë rritje dyshifrore, ndonëse më të ulëta krahasuar me tremujorin paraprak. Nga ana tjetër, masa e pensione¹⁰ dhe masa e pagave të paguara¹¹ shënuan rënie reale më të lartë, dhe njëkohësisht rënie reale vjetore më të lartë shënuan edhe kreditimi i popullsisë nga bankat.

Nga pikëpamja e të dhënave të disponueshme për lëvizjet në konsumin personal¹² për tremujorin e katërt të vitit 2022, rënia reale vjetore në pjesë e përbërësve të të ardhurave


⁹ Pas paketës së miratuar prej 26 masash për mbrojtjen e standardit të jetesës dhe likuiditetit të kompanive në fillim të muajit mars, si dhe vendimit për kushte të veçanta për tregtimin e mallrave individuale, i miratuar më 14 qershor 2022, i cili përcaktonte marzhi më i lartë tregtar i produkteve ushqimore bazë në tregtinë me shumicë dhe pakicë dhe gjatë tremujorit të tretë vazhduan masat shitesë. Kështu, më 20 korrik 2022 u morën dy vendime që ndalonin eksportin e druve të zjarrit, peleteve dhe grurit dhe miellit, si dhe u hoq taksa doganore për importin e vajit të gatimit deri në fund të vitit. Gjithashtu, më 11 gusht 2022 janë marrë edhe dy vendime të tjera dhe konkretisht: Vendimi për kufizimin e eksportit të mallrave të caktuara, i cili do të zbatohet edhe për farat e lulediellit, përfshirë të thyer apo të grimcuara, me vlefshmëri deri më 31 dhjetor 2022 dhe Vendimi për kushte të veçanta për tregtimin e mallrave të caktuara, i cili përcakton marzhin më të lartë tregtar, në shumën nga maksimumi deri në 10%, si kusht i veçantë në tregti për mallrat e mëposhtëm: dru zjarri dushku, dru zjarri ahu dhe pelet për zjarri i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2022. Më 30 gusht 2022 u mor vendimi për të hequr përkohësisht (deri më 31 dhjetor 2022) normën doganore prej 20 për qind për qumështin dhe ajkën, jo të koncentruar dhe pa sheqer të shtuar apo ëmbëlsues të tjerë me përmbajtje yndyre në masë që kalon 21%. por jo më shumë se 45% dhe norma doganore 15% për qumështin dhe ajkën, të pakoncentruar dhe pa sheqer të shtuar me një përmbajtje yndyre në masë që kalon 10% por jo më shumë se 45% në paketim, masa neto e të cilave nuk i kalon 2.5 kg. Importi i këtyre markave tarifore nga vendet e CEFTA-s është pa doganë dhe nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian kryhet me një normë doganore prej 5%. Më 9 shtator 2022, u miratua Vendimi për përcaktimin e marzhit maksimal prej 10% për tregtimin në tregun e energjisë elektrike me vlefshmëri deri më 15 prill 2023. Më datë 20.09.2022 u vendos që masa për përcaktimin e marzhit më të lartë tregtar të produkteve ushqimore bazë në tregtinë me shumicë dhe pakicë të miratuar më 14 qershor 2022, të vazhdojë deri në fund të vitit. Gjithashtu më 28 shtator 2022, Këshilli Ekonomik dhe Energjetik mori vendime lidhur me sigurimin e ngrohjes dhe energjisë elektrike. Për energjinë elektrike u vendos që: shteti do të subvencionojë 80% të faturës së energjisë elektrike për 650 mijë familje, kurse konsumatorët e vegjël (kompanitë dhe personat e tjerë juridikë me qarkullim vjetor maksimal prej 2 milionë euro ose rreth 70 mijë subjekte) do të marrin subvencion energji elektrike me një çmim që është tre herë më i ulët se çmimi i bursës; shkollat fillore dhe të mesme në mbarë vendin do të furnizohen në tregun e rregulluar të energjisë elektrike; Të gjitha institucionet publike dhe shëndetësore do të pajisen me energji elektrike përmes "EMV" me çmim më të favorshëm se çmimi i bursës.

¹⁰ Me pensionin e shtatorit, pensionet u rregulluan sipas metodologjisë së re, e cila parashikon rregullimin e pensioneve me një model të kombinuar 50% rritje të pagës mesatare të të gjithë punësuarit në shtet dhe rritje 50% të shpenzimeve të jetesës, sipas të dhënave zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave. Për më shumë shihni [lidhja](#).

¹¹ Më shumë detaje në pjesën 1.3. Punësimi dhe pagat.

¹² Të dhënat e pagave janë për muajin tetor 2022, ndërsa të dhënat për kreditë e popullsisë, pensionet, tregtinë me pakicë, prodhimin vendas të mallrave të konsumit, importin e mallrave të konsumit dhe të ardhurat bruto nga TVSH-ja i referohen periudhës tetor – nëntor 2022.

të disponueshme, përkatësisht paga dhe pensione¹³, ndërsa vazhdon edhe rënia reale vjetore të kredive për popullsinë. Rezultatet e Anketës së aktivitetit kreditor të muajit dhjetor tregojnë për një neto-shtrëngim të kushteve të përgjithshme të kredisë dhe një neto-ulje të kërkesës për kreditë totale të familjeve. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, ka vazhduar rënia e bazës reale të tregtisë me pakicë, importin e mallrave të konsumit të gjerë, me rënie të prodhimit vendas të mallrave të konsumit dhe të hyrave bruto nga TVSH-ja. Për sa i përket treguesit të besimit të konsumatorit¹⁴, ai tregon për perceptime më të favorshme për tremujorin e katërt 2022 krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 është më pak i favorshëm. Nën ndikimin e efekteve negative afatgjata të luftës në Ukrainë mbi çmimet dhe ofertën, si dhe përballë ndryshueshmërisë së theksuar dhe pasigurisë së kushteve të jashtme ekonomike dhe financiare, vazhduan të ndërmerren masa ekonomike shtesë për të mbrojtur standardin e jetesës dhe likuiditetit të kompanive¹⁵.



¹³ Në përputhje me pakon e re të masave të synuara për ndihmë të grupeve më të cenueshme të qytetarëve të miratuar në tetor, në 4 muajt e ardhshëm (nëntor dhe dhjetor 2022 dhe janar dhe shkurt 2023) është planifikuar të paguhet nga 1.500 denarë për pensionistët që marrin pension deri në 11.525 denarë dhe 750 denarë për pensionistët me pensione nga 11.525 deri në 14.000 denarë.


¹⁴ Anketa e Komisionit Evropian mbi optimizmin e konsumatorëve që nga dhjetori 2022. Në ekranin grafik, indeksi i besimit të konsumatorit shfaqet si përqindje neto e përgjigjeve. Ky indeks është një komponent përbërës i indeksit të përgjithshëm të besimit ekonomik.

¹⁵ Dhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022 ka vijuar zbatimi i masave ekonomike për mbrojtjen e standardit të jetesës dhe likuiditetit të kompanive. Kështu, më 9 tetor 2022, Qeveria miratoi një paketë të re masash për mbështetjen financiare të kategorive më të prekuara të qytetarëve, pensionistëve dhe kompanive, dhe ajo përmban masa të synuara për kategoritë më të prekura të qytetarëve; mbështetje e synuar për institucionet publike dhe shëndetësore; mbështetjen e likuiditetit të kompanive; investimet në efikasitetin energjetik dhe burimet e rinovueshme të energjisë. Më 30 tetor 2022, Qeveria mori vendim për çmime më të favorshme të energjisë elektrike për kompanitë nga industria ushqimore prej 80 euro për megavat/orë (vlen për prodhuesit e vajit ushqimor, bukës dhe produkteve të furrës, miellit, qumështit dhe produkteve të qumështit, mishit dhe industria e shpendëve) me të cilin çmimet e produkteve të tyre duhet të ulen për së paku 10%, si dhe një Vendim me të cilin shkollat publike fillore dhe të mesme, si dhe ndërmarrjet publike në fushën e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të zeza që operojnë me stacionet e pompimit dhe pastrimit mund të lidhin kontratë për furnizim me energji elektrike me "EMV Shitje", me çmim 95 euro për megavat/orë, në përputhje me gjendjen e deklaruar të krizës në furnizimin me energji elektrike. Më 2 nëntor 2022, Qeveria ka miratuar Vendim për përcaktimin e çmimeve më të larta në tregtinë me pakicë të druve të zjarrit të dushkut, druve të ahut dhe peleteve për zjarr. Në të njëjtën kohë, Qeveria mori Vendim për ndërprerjen e vlefshmërisë së vendimit për kushte të veçanta në tregtinë me pakicë, i cili ngriu marzhin e druve të zjarrit të dushkut dhe ahut dhe peletit për të gjithë tregtarët deri në 10%. Më 4 nëntor 2022, Qeveria mori Vendim për vazhdimin e mbrojtjes së amvisërve nga çmimi më i lartë i energjisë termike. Më 26 dhjetor 2022, në përputhje me Buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë për vitin 2023 janë siguruar mjetet për përballimin e krizës energjetike dhe për të mbështetur familjet dhe kompanitë, si dhe masa për ngirjen e marzheve të produkteve ushqimore bazë është zgjatur deri në fund të prillit 2023.

1.3.1. Konsumi publik

Edhe në tremujorin e tretë të vitit 2022, konsumi publik shënoi një rënie reale vjetore prej 4,7%, që ishte disi më e ulët në krahasim me tremujorin paraprak (rënie prej 5,2%), e cila në bazë tremujore shënoi një rritje të vogël prej 0,8%. Sipas të dhënave nga buxheti, edhe në këtë periudhë është vërejtur një rënie në të gjitha kategoritë kryesore të konsumit publik, më e theksuar në shpenzimet për paga dhe fondin e shëndetësisë.

Arritjet buxhetore sipas të dhënave fiskale për periudhën tetor – nëntor 2022 tregojnë një rënie reale vjetore në **konsum publik** në tremujorin e katërt të vitit, por më e vogël, në kushte rënieje pothuajse në të gjithë kategoritë kryesore (përveç për transferimet deru në APRMV).



Burimi: Ministria e Financave dhe Ilogaritjet e BPRMV-së.
Në Ilogaritjet janë marrë shpenzimet e publikuara në buxhetin e konsoliduar të Qeverisë Qëndrore dhe Fondeve, të deflatuara nga kostoja e jetës.



1.3.2. Konsumi i investimeve

Pas rritjes së fortë dyshifrore të bruto-investimeve në dy tremujorët e mëparshëm, këto vazhduan të rriten në tremujorin e tretë të vitit 2022, por me një ritëm më të ngadaltë, me rritje reale vjetore prej 9,0% dhe një rënie tremujore prej 13,9%. Ngjashëm me tremujorët e mëparshëm, rritja e kësaj kategorie edhe më tej vazhdon të lidhet kryesisht me rritje të stoqeve, në kushtet e ndikimeve të pafavorshme të luftës në Ukrainë në ofertë dhe çmime. Nga pikëpamja e kategorive treguese për investime, edhe këtë tremujor kanë shënuar rritje të hyrat nga tatimi mbi fitimin, importi i makinerive dhe pajisjeve, si dhe prodhimi vendas i mallrave kapitale gjithashtu ka shënuar rritje më të lartë. Pas rënies në tremujorin paraprak, rritje në tremujorin e tretë të vitit 2022 shënuan edhe investime të huaja direkte. Nga ana tjetër, investimet kapitale të shtetërore shënuan një rënie të lartë dyshifrore. Gjithashtu, rënie më e madhe është vërejtur në punët ndërtimore të kryera, si dhe në kredinë afatgjatë të ndërmarrjeve.

Në lidhje me të dhënat me frekuencë të lartë për bruto -investimet¹⁶, në periudhën tetor-nëntor 2022 vazhdon rënia e prodhimit të përgjithshëm industrial, kredia afatgjatë e ndërmarrjeve, si dhe rënie e vogël është vërejtur edhe në importin e pajisjeve për punë. Gjithashtu, në muajin tetor, një rënie më e madhe është vërejtur punët ndërtimore të kryera. Nga ana tjetër, rritje është vërejtur në prodhimtarinë vendase të produkteve kapitale, ndërsa ka vazhduar rritja e tatimit mbi fitimin. Pas rënies në tremujorin e tretë, në periudhën tetor-nëntor 2022, rritje

¹⁶ Të dhënat për punët ndërtimore të përfunduara dhe stoqet e produkteve të gatshme janë të korrikut 2022, ndërsa të dhënat për kreditë afatgjata për ndërmarrjet, investimet kapitale shtetërore, prodhimin industrial, importin e produkteve të investimeve dhe prodhimin vendas të produkteve kapitale i referohen periudhës korrik - gusht 2022.



shënuan edhe investimet kapitale shtetërore. Gjithashtu, në tetor 2022 ka vazhduar rritja vjetore e stokeve të produkteve të gatshme. Rezultatet e Anketës të aktivitetit kreditor për tremujorin e tretë tregojnë për një neto-shtrëngim në të kushteve të përgjithshme të kreditimit dhe për një neto-rritje të kërkesës për kredi për korporatat.



1.3.3. Kërkesa neto për eksport

Edhe në tremujorin e tretë të vitit 2023, neto-eksportet patën një kontribut negativ në PBB, në kushtet e rritjes disi më të lartë të importeve në raport me rritjen e eksporteve. Konkretisht, eksportet vazhduan të rriten, duke arritur një normë dyshifrore të rritjes vjetore prej 17.8%, pa ndryshime në baza tremujore (rritje vjetore dhe tremujore përkatësisht 14.2% dhe 4.0%, në tremujorin paraprak). Kështu, ai ishte komponenti me kontributin më të lartë pozitiv individual në rritjen e PBB-së. Analizuar sipas vlerave nominale nga statistikët e tregtisë së jashtme, kontributin më të madh në arritje të tilla e kanë kompanitë me pronësi të huaj që lidhen me industrinë e automobilave që janë të orientuara nga eksporti. Kontribut pozitiv ka shënuar edhe eksporti i energjisë dhe ushqimit. Një rritje e tillë e eksporteve, por mbi të gjitha rritja e kërkesës për investime lidhur me krijimin e stokeve në kushte të mëtejshme pasigurie të përgjithshme dhe rritje të çmimeve, çuan në rritje të mëtejshme të importeve, të cilat në tremujorin e tretë 2022 arritën në 19.4% (me një minimum tremujor rënie prej 0.1%).

Të dhënat për shkëmbimin e tregtisë së jashtme në periudhën tetor-nëntor 2022 tregojnë për një zgjerim të mundshëm të deficitit në tremujorin e katërt të vitit në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me një rritje më të lartë të importeve sesa eksportet e mallrave në shumatat absolute.





1.4. Punësimi dhe pagat

Zhvendosjet në tregun e punës gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022 reflektojnë pjesërisht kushtet në ekonomi. Në kushtet e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, me pasiguri të lartë nga zhvillimi i luftës në Ukrainë dhe lëvizjet e turbullta të tregut të energjisë, numri i të punësuarve shënoi stagnim, përkatësisht mbeti i pandryshuar në krahasim me tremujorin paraprak. Në të njëjtën kohë, numri i të papunëve u ul me 1,7%. Për rrjedhojë, shkalla e punësimit mbeti në nivelin 47.3%, me ulje të mëtejshme të shkallës së papunësisë, e cila u ul në 14.3%. Nga pikëpamja e ofertës së fuqisë punëtore, në tremujorin e tretë u shënua një ulje minimale e popullsisë aktive, në kurriz të rritjes minimale të popullsisë joaktive. Anketat e tendencave të biznesit tregojnë për pritshmëri më optimiste midis drejtuesve të biznesit në lidhje me punësimet e reja në tremujorin e katërt të vitit 2022, krahasuar me pritjet për tremujorin paraprak.


Lëvizjet në tregun e punës¹⁷ tregojnë për një stabilizim gradual të këtij segmenti të tregu në kushtet e një aktiviteti më të dobët ekonomik dhe pasigurisë së lartë për shkak të zhvillimit të luftës në Ukrainë dhe lëvizjeve të trazuara në tregun e energjisë. Kështu, në tremujorin e tretë të vitit 2022 është vërejtur një stagnim i numrit të të punësuarve në bazë tremujore. Megjithatë, duke parë aktivitetet individuale vërehen zhvendosje të caktuara, ku kontributin më të madh pozitiv e kanë aktivitetet që kanë të bëjnë me "industri përpunuese", "transport dhe magazinim", "tregti me shumicë dhe pakicë", "veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike"., "veprimtari të tjera shërbimi" dhe "veprimtari financiare dhe veprimtari sigurimi". Nga ana tjetër, një kontribut negativ më të theksuar kanë aktivitetet "arsim", "administratë publike dhe mbrojtje", "ndërtimtar", "informacion dhe komunikim" dhe "veprimtaritë e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale". Për sa

¹⁷ Gjatë përpunimit të të dhënave për tre tremujorin e parë të vitit 2022, shpërndarjet demografike rajonale sipas gjinisë dhe sipas grupmoshave pesëvjeçare janë përdorur për të kalibruar popullsinë sipas të dhënave nga Regjistrimi i vitit 2021. Prandaj, edhe ky raport është në formë të modifikuar dhe të shkurtuar, deri në marrjen e të dhënave të përpunuara dhe të harmonizuara për vitet e kaluara për këtë segment sipas regjistrimit të fundit. Prandaj, pjesa më e madhe e analizës së të dhënave i referohet ndryshimeve në baza tremujore me të dhëna të parregulluara sezonale.

i përket statusit ekonomike¹⁸, rritje tremujore vihet re në kategorinë "vetëpunësuar", ndërsa në kategoritë "punëdhënës" dhe "punëtorë familjarë të papaguar" ka lëvizje negative.





Në kushtet e numrit të pandryshuar të të punësuarve, shkalla e punësimit është 47.3% e njëjtë me tremujorin paraprak. **Sinjalet e Anketës së tendencave të biznesit¹⁹, mesatarisht, kryesisht tregojnë për optimizëm** midis drejtuesve të biznesit në lidhje me pritjet e punësimit në tremujorin e katërt të vitit 2022. Kështu, mesatarisht, ankeat e realizuara gjatë tremujorit të katërt tregojnë një optimizëm të moderuar në lidhje me pritjet për rritje të numrit të të punësuarve krahasuar me tremujorin e mëparshëm në tregtinë me pakicë dhe shërbime, ndërsa në ndërtimtari dhe industri pritshmëritë janë më pak të favorshme, por megjithatë raporti i udhëheqësve që presin rritje të numrit të të punësuarve është pozitiv. Megjithatë, në kushte të çrregullimit të mëtejshme në tregun e energjisë dhe efekteve negative të luftës në Ukrainë, anketa e realizuara në dhjetor janë paksa më pak të favorshme për sa i përket pritjeve për rritje të numrit të të punësuarve për periudhën e ardhshme, krahasuar me anketat e nëntorit.



¹⁸ Klasifikimi sipas gjendjes ekonomike i referohet grupeve të mëposhtme: **punëdhënës** – persona që drejtojnë subjektin e tyre afarist ose janë pronarë që punojnë në dyqanin e tyre, ose janë pronarë të pronës së tyre bujqësore dhe punësojnë persona të tjerë; **të punësuarit** – persona që punojnë në institucione shtetërore, subjekte afariste në pronësi shoqërore, të përzier, kooperativë dhe të pacaktuar ose me punëdhënës privat; **të punësuar për llogari të tyre** – persona që kanë subjekt afarist, biznes, në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari dhe punojnë në pronë bujqësore për të krijuar të ardhura dhe nuk punësojnë persona të tjerë; **punëtorë familjarë të papaguar** – persona që punojnë pa pagesë në një subjekt afarist, dyqan apo pronë bujqësore (në pronësi të një anëtarit të tyre të familjes).

¹⁹ Burimi: Komisioni Evropian, sondazhi mbi tendencat e biznesit, pritshmëritë e punësimit në 3 muajt e ardhshëm në industri, shërbime, tregti me pakicë dhe ndërtimtari (sondazhe të kryera në tetor, nëntor dhe dhjetor 2022).

Në tremujorin e tretë 2022, **shkalla e vendeve të lira të punës²⁰ ishte 2.1%** (1.7% në tremujorin korrespondues të 2021). Shkalla e vendeve të lira të punës ka qenë relativisht e qëndrueshme për një periudhë të gjatë kohore, gjë që tregon për një përmirësim të mundshëm në procesin e lidhjes së ofertës me kërkesën për aftësi në tregun e punës. Shikuar nga aktivitetet, ritmet më të larta të vendeve të lira të punës vërehen në aktivitetet që u prekën më shumë nga pandemia, aktivitetet që lidhen me aftësitë e TIK-ut, si dhe në aktivitetet që shënojnë rritje të vazhdueshme të aktivitetit të tyre. Kështu, përqindjet më të larta të vendeve të lira të punës janë gjetur në "transporti" (3,8%), "informacion dhe komunikim" (3,5%), "objekte akomodimi dhe shërbime ushqimore" (3,5%), "veprimtari shërbimi administrativ dhe ndihmës" (3,4%), "ndërtimtari" (2,6%), si dhe "art, argëtim dhe rekreacion" (2,3%).




Në tremujorin e tretë të vitit 2022, vërehet një rënie minimale e ofertës së fuqisë punëtore. Në fakt, totali i popullsisë aktive në tremujorin e tretë shënoi një rënie minimale prej 0.3% në bazë tremujore, e cila u reflektua edhe në normat e aktivitetit, e cila u ul minimalisht dhe arriti në 55.2% (kundër 55.3% në tremujorin e fundit). Me këtë, në këtë tremujor vërehet një rritje minimale e popullsisë joaktive (me 0.1%).

Rritja e pandryshuar e kërkesës në raport me uljen minimale të ofertës së punës në tremujorin e tretë të vitit 2022 çoi në një rënie të mëtejshme të papunësisë. Kështu, numri i të papunëve në tremujorin e dytë u ul me 1.7% në bazë tremujore, ndërsa shkalla e papunësisë u ul në nivelin 14.3% (rënie tremujore prej 0.2 p.p.). Kjo lëvizje e shkallës së papunësisë është rezultat i uljes së mëtejshme të numrit të të personave të papunësuar, në kushtet e lëvizjeve të pandryshuara të numrit të të punësuarve dhe rritjes minimale të popullsisë joaktive.

Pagat mesatare neto dhe bruto të paguara në tremujorin e dytë shënuan rritje të mëtejshme vjetore. Kështu, pagat bruto dhe neto në tremujorin e dytë shënuan një rritje vjetore përkatësisht prej 11.8% dhe 12%, (në tremujorin paraparak, përkatësisht një rritje prej 10.4%,). Rritja vjetore e pagës është pjesërisht rezultat i rritjes së pagës minimale prej 18.5% në mars 2022,

²⁰ Shkalla e vendeve të lira të punës është raporti ndërmjet numrit të vendeve të lira dhe numrit total të vendeve të punës. Zakonisht, shkalla e punës konsiderohet së bashku me shkallën e papunësisë (një marrëdhënie e njohur si kurba e Beveridge). Vendosja e këtyre dy treguesve jep informacion mbi efikasitetin e tregut të punës përsa i përket mospërputhjeve të mundshme midis profileve të kërkuara dhe atyre të disponueshme në tregun e punës në një moment të caktuar (angl. skill mismatches). Në veçanti, nëse të dy treguesit lëvizin në të njëjtën kohë, bëhet fjalë për luhatje të përkohshme, ciklike, ndërsa në rastin kur shkalla e papunësisë zvogëlohet, me një normë të qëndrueshme të vendeve të lira, bëhet fjalë për ndryshime strukturore, përkatësisht përmirësim të efikasitetit të tregut të punës.

në përputhje me ndryshimet më të fundit ligjore²¹, s ndikim ka edhe rritja e një pjesës së pagave të sektorit publik²² në shtator 2022, si dhe nga disa faktorë strukturorë, si mungesa e fuqisë punëtore në segmente të caktuara të tregut të punës. Analizuar sipas aktiviteteve, rritje vjetore e pagave është vërejtur pothuajse në të gjitha aktivitetet ekonomike, ndërsa rritje më të lartë e kanë shënuar ende aktivitetet e prekura nga pandemia, paragjithash aktiviteteve shërbyese, siç janë: "objektet për akomodim dhe aktivitetet e shërbimit ushqimor", "artet, argëtimi dhe rekreacioni", "industria përpunuese", "ndërtimtaria", "tregtia" dhe "aktivitetet administrative dhe ndihmëse". Rritje të ndjeshme të pagave ka edhe në "aktivitetet administrative dhe ndihmëse", "veprimtari tjera shërbyese" dhe "transport dhe magazinim". Në kushtet e rritjes së përshpejtuar të çmimeve të konsumit prej 17,2%, **paga reale neto dhe bruto në tremujori i dytë u ul përkatësisht me 4,6% dhe 4,4% me bazë vjetore**. Në tetor 2022, rritja e pagës mesatare nominale neto arriti në 13.6%, ndërsa paga neto reale regjistroi një rënie prej 5.2%.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

*Податокот за квартал 3 2023 е заклучно со месец јули 2023 год.

Produktiviteti i punës²³ rritet gjithashtu në tremujorin e tretë të vitit 2022, por më ngadalë, duke arritur një normë rritjeje vjetore prej 2.6%²⁴ (ritje 4.6% në tremujorin paraprak). Rritja e produktivitetit në tremujorin e tretë është rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik në kushtet e stagnimit të punësimit, me bazë vjetore. Shikuar sipas sektorëve, rritja e produktivitetit vjen kryesisht nga sektori i shërbimeve dhe në një masë më të vogël nga bujqësia, në kushtet e rënies së industrisë. **Në tremujorin e tretë të vitit 2022, shpenzimet nominale të punës për njësi produkti shënuan një rritje vjetore prej 9,8%** (kundër rritjes prej 6,4% në tremujorin paraprak). Rritja e shpenzimeve të punës vjen si pasojë e rritjes së mëtejshme të moderuar të bruto pagave nominale, ndërkohë që rritja e produktivitetit ngadalësohet. Madje, pjesa më e madhe e


²¹ Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e fundit ligjore për rritjen e pagës minimale ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 41/22) nga marsi 2022, është bërë rritje e jashtëzakonshme e pagës minimale neto për 2806 denarë, në përputhje me marrëveshjen trepalëshe të arritur në mes të Qeverisë, sindikatave dhe punëdhënësve, ku shteti do të subvencionojë pjesën që ka të bëjë me kontributet (nga marsi 2022 deri në dhjetor 2022 në shumë prej 1197 denarë për çdo muaj). Shuma e pagës minimale në shumën bruto, duke filluar nga marsi 2022 deri në shkurt 2023, është 26.422 denarë (më parë 22.146 denarë), gjegjësisht paga minimale në shumën neto është 18.000 denarë (më parë 15.194 denarë). Gjithashtu, me ndryshimet dhe plotësimet e fundit është vendosur një metodologji e re me të cilën do të harmonizohet paga minimale në periudhën e ardhshme, përkatësisht nga marsi i vitit 2023, pra me rritjen për vitin paraprak të pagës mesatare të paguar në RMV dhe indeksi i shpenzimeve të jetesës - përkatësisht 50 % e rritjes nga secili tregues. Gjithashtu është përcaktuar se shuma e pagës minimale nuk mund të jetë më e ulët se 57% e shumës së pagës mesatare neto të paguar në RMV për vitin paraprak.

²² Sipas ribalancimit të Buxhetit, në pagën e shtatorit ka rritje 15% për të punësuarit në drejtësi, në shkollat fillore dhe mesme dhe në çerdhe, rritje 7% të pagave për të punësuarit në arsimin e lartë dhe 5% rritje të pagave për të punësuarit në MPB dhe në shëndetësi.


²³ Produktiviteti total i punës llogaritet si një shumë e ponderuar e produktivitetit të llogaritur në nivel sektori individual. Brenda çdo sektori, produktiviteti llogaritet si raport ndërmjet vlerës së shtuar në atë sektor dhe numrit të personave të punësuar.

²⁴ Të dhënat për produktivitetin total dhe shpenzimet nominale të punës për njësi prodhimi janë llogaritje të brendshme të Bankës Popullore dhe duhet të interpretohen me kujdes. Në fakt, sipas Regjistrimit të Popullsisë, Familjeve dhe Banesave të vitit 2021, ka pasur një ndërprerje strukturore në seri për numrin e të punësuarve në TM1 të vitit 2022. Me qëllim të vazhdimet me një analizë të qëndrueshme të produktivitetit dhe shpenzimeve të punës për njësi produkti, u bë përshtatja e të dhënave zyrtare për numrin e të punësuarve.

rritjes së shpenzime të punës për njësi shpjegohet me shpenzime më të larta në sektorin e shërbimeve dhe industrisë.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV-




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV-së.

1.5. Inflacioni

Në tremujorin e katërt të vitit 2022, norma e inflacionit ishte 19.3% me bazë vjetore. Inflacioni ende përcaktohet kryesisht nga faktorë të jashtëm, përkatësisht nga rritja e çmimeve të importit të ushqimeve dhe energjisë. Këto ndryshime janë shkaktuar nga ndërprerjet në tregjet globale të produkteve bazë, në kushtet e zgjatjes së luftës në Ukrainë dhe sanksioneve dhe kufizimeve tregtare të vendosura kundër Rusisë. Çmimet e ushqimeve në tregun vendas kanë vijuar të rriten, pjesërisht nën ndikimin e efekteve të transferuara të rritjes së nivelit të çmimit të energjisë. Është i mundur zbutja pjesërisht e këtij efekti nëpërmjet masave të marra, lidhur me furnizimin me energji elektrike të prodhuesve vendas të produkteve ushqimore, duke filluar nga muaji i fundit i vitit. Duke patur parasysh se ushqimi dhe energjia janë një komponent hyrës i shumë produkteve dhe shërbimeve të tjera, në tremujorin e fundit u vu re rritje edhe në inflacionin bazë. Për të gjithë vitin 2022, norma mesatare vjetore e inflacionit është në përputhje me pritjet dhe arrin në 14.2%. Për sa i përket faktorëve që do të ndikojnë në dinamikën e ardhshme afatshkurtra të çmimeve të konsumit, vërehet një ngadalësim i ritmit të rritjes së çmimeve të prodhuesve vendas dhe një stabilizim i inflacionit të importuar nga jashtë, ndërkohë që një përshpejtim i caktuar i shpenzimeve nominale të punës për njësi produkti vihet re rritje vjetore në tremujorin e tretë. Për sa i përket pritjeve për normën e inflacionit në periudhën e ardhshme, sipas Anketës së Bankës Popullore, analistët ekonomikë presin një normë inflacioni prej 7.8% në vitin 2023 dhe 4.3% në vitin 2024, të cilat janë të ngjashme me pritjet nga anketa e mëparshme dhe në përputhje me dinamikën e parashikuar të inflacionit të Bankës Popullore dhe institucioneve ndërkombëtare.

1.5.1. Inflacioni aktual

Në tremujorin e katërt 2022, norma vjetore e inflacionit arriti në 19.3% (17.2% në tremujorin paraprak)²⁵. Efekti më i madh në këtë dinamikë është ende kontributi në rritje i çmimeve të ushqimeve mbi inflacionin, i plotësuar nga trendi rritës të inflacionit bazë. Çmimet e komponentit të energjisë, pavarësisht rritjes së ngadaltë të shkaktuar nga ngadalësimi i rritjes së çmimeve të brendshme të derivateve të naftës, mbeten në zonën e ndryshimit dyshifror. Lëvizje të tilla në çmimet e brendshme vazhdojnë të jenë kryesisht një reflektim i faktorëve të ofertës dhe rritjes së çmimeve të importit, të shkaktuara nga ndërprerjet në tregjet globale të mallrave, të lidhura me kohëzgjatjen e luftës në Ukrainë dhe sanksionet dhe kufizimet tregtare të vendosura ndaj Rusisë



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV.

Inflacioni bazë në tremujorin e katërt 2022 është 9.8% me bazë vjetore (6.5% në tremujorin), i cili më së shumti vjen si pasojë e çmimeve më të larta të shërbimeve në restorante dhe hotele, të shoqëruara me rritjen e shpenzimeve të ushqimit dhe energjisë. Kontribut më të rëndësishëm kanë çmimet e pijeve joalkoolike, të duhanit²⁶, çmimet e produkteve për higjienën personale dhe mirëmbajtjen rutinë të amvisërive dhe çmimet e trafikut rrugor. Nën-indeksat e tjera të inflacionit, të cilët përjashtojnë çmimet më të luhatshme, gjithashtu shënuan rritje të përshpejtuar në tremujorin e katërt, krahasuar me tremujorin paraprak. Kështu, në indeksin total me përjashtim të energjisë²⁷, karburantët djegës dhe lubrifikantët të lëngshëm (për transport) dhe ushqimet e papërpunuara, vërehet një rritje vjetore prej 17.6% (15.1% në tremujorin paraprak), ndërsa në indeksin total me përjashtim të energjisë, karburantët djegës lubrifikantët të lëngshëm (për transport), ushqime të papërpunuara, duhani dhe pije alkoolike, norma vjetore e rritjes është 18.2% (15.7% në tremujorin paraprak).

²⁵ Në bazë tremujore, çmimet e konsumit të brendshëm janë më të larta për 3.1%, dhe me bazë sezonale të rregulluara për 3.9%.

²⁶ Çmimet e pjesës më të madhe të markave dhe llojeve të cigareve janë rritur për 10 denarë që nga shkurti i vitit 2022, si rezultat i trendit të rritjes së çmimeve të lëndëve të para, ripromaterialeve dhe energjisë, para së gjithash gazit dhe energjisë elektrike, të cilat kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në prodhim, si dhe për shkak të rritjes së rregullt vjetore të akcizës (çdo vit, duke filluar nga viti 2013 deri më 1 korrik 2023, akciza për cigaret rritet për 0,2 denarë/copë).

²⁷ Kategoria "energji" i referohet energjisë elektrike, gazit, karburenteve djegës të lëngshme dhe të ngurta për ngrohje dhe ngrohje qendrore.



	(ndryshime vjetore, në %)										(kontribute ndaj ndryshimeve vjetore, në p.p.)									
	2021					2022					2021					2022				
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	2021	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	2022	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	2021	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	2022
Tregues i çmimeve të konsumit - gjithsej	2.0	2.8	3.5	4.6	3.2	7.7	12.3	17.2	19.3	14.2	2.0	2.8	3.5	4.6	3.2	7.7	12.3	17.2	19.3	14.2
Ushqimi	2.1	1.5	3.6	6.1	3.3	10.4	18.0	26.7	30.3	21.5	0.8	0.6	1.3	2.2	1.2	3.8	6.7	9.9	11.4	8.0
Çmimet e energjisë	3.2	9.9	6.0	6.6	6.4	13.4	17.8	25.5	23.6	20.2	0.4	1.2	0.8	0.9	0.8	1.8	2.3	3.4	3.1	2.7
Energjia elektrike	7.4	7.4	2.4	0.0	4.3	9.4	9.4	20.2	20.2	14.8	0.5	0.5	0.2	0.0	0.3	0.7	0.7	1.5	1.5	1.1
Ngrohje qëndrore	0.0	0.0	-2.7	-4.0	-1.7	9.4	9.4	23.0	30.1	17.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1
lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantet	-3.5	25.3	20.0	27.7	17.4	29.1	42.0	37.7	21.2	32.3	-0.1	0.7	0.6	0.8	0.5	0.9	1.4	1.3	0.8	1.1
Ushqimi dhe energjia (çmime të luhatshme)	2.3	3.6	4.2	6.2	4.1	11.2	18.0	26.4	28.6	21.2	1.2	1.8	2.1	3.1	2.0	5.6	9.1	13.2	14.5	10.7
Inflacioni bazë i llogaritur nga BPRMV-ja (treguesi total - ushqimi dhe energjia (kategoritë 01.1, 04.5, 07.2.2))	1.6	2.0	2.9	3.0	2.4	4.2	6.5	7.9	9.8	7.1	0.8	1.0	1.5	1.5	1.2	2.1	3.2	3.9	4.8	3.5
Treguesi total duke përfshirur energjinë, lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantet dhe ushqimin e papërpunuar (EShS)	1.9	2.2	2.9	3.9	2.7	6.0	10.4	15.1	17.6	12.3										
Treguesi total duke përfshirur energjinë, lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantet, ushqimin e papërpunuar, duhanin dhe pijet alkoolike (EShS)	1.5	2.1	2.8	4.2	2.6	6.1	10.5	15.7	18.2	12.7										

Burim: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Çmimet e ushqimeve në tremujorin e katërt 2022 shënuan një rritje vjetore prej 30.3% (26.7% në tremujorin e mëparshëm). Për nga struktura, rritja e çmimeve të ushqimeve vjen kryesisht nga rritja e çmimeve në kategoritë "bukë dhe drithëra", "qumësht, djathë dhe vezë" dhe mish, të cilat shpjegojnë afërsisht tre të katërtat e rritjes së çmimeve të komponentit ushqimor. Për të zbutur presionet e çmimeve në produktet ushqimore, u miratuan masa për të kufizuar marzhet tregtare të shumicës së këtyre produkteve²⁸, heqjen e tarifës doganore për importin e vajit të lulediellit ushqimor dhe për importin e qumështit dhe ajkës²⁹, si dhe masat lidhur me energjinë elektrike për të ndikuar në uljen dhe stabilizimin e çmimeve të produkteve ushqimore vendase³⁰. Rritja e lartë dhe afatgjatë e çmimeve të ushqimeve përcaktohet kryesisht nga faktorë të jashtëm, si rritja e çmimeve të produkteve ushqimore bazë në tregun ndërkombëtar, efekti i transferuar i çmimeve më të larta të energjisë elektrike dhe produkteve të naftës në shpenzimet operative, rritja e çmimeve të plehra artificiale, ushqim për kafshë dhe inpute të tjera në prodhimin primar, si dhe mbiçmimi i dollarit amerikan. Në tremujorin e katërt, çmimet e huaja efektive të ushqimevetë


²⁸ Me Vendimin për kushte të veçanta për tregtimin e mallrave të caktuara, të miratuar më 14 qershor 2022, Qeveria e RMV caktoi marzhin më të lartë tregtar të produkteve ushqimore bazë në tregtinë me shumicë dhe pakicë, i cili fillimisht ishte i vlefshëm deri më 30 shtator dhe më pas u vendos për të vazhduar zbatimin e tij deri në fund të vitit. Sipas vendimit, për bukën e bardhë (të prerë në copa ose të plota), për sheqerin e bardhë dhe për vajin e lulediellit ushqimor, me përjashtim atë të shtrydhur të ftohtë, përcaktohet marzhi tregtar deri në 5% në tregtinë me shumicë dhe deri në 5% në tregtinë me pakicë, ndërsa për miellin e grurit (tip 400 dhe tip 500), për makarona dhe spagetat nga gruri i fortë, orizi i bardhë maqedonas, qumështi i përhershëm i lopës me përmbajtje yndyre 2,8%, 3,2% dhe 3,5% dhe vezët nga pule, për të gjitha shoqëritë tregtare dhe tregtarët individualë që marrin pjesë në zinxhirin tregtar, vendoset një marzh tregtar deri në 10% në tregtinë me shumicë dhe deri në 10% në tregtinë me pakicë. Sipas këtij Vendimi, shpenzimet operative nuk do të llogariten për këto produkte dhe nuk miratohen zbritjet dhe kompensim që shiten me pakicë i ngarkon shitësit me shumicë për reklamat dhe për paraqitjen e mallrave në rafte në pozicione parësore dhe dytësore.

²⁹ Më 20 korrik 2022, qeveria e MV solli vendim për vazhdimin e aplikimit të importit pa taksë doganore të vajit të ushqimit të lulediellit deri në fund të vitit, i cili më parë ishte i vlefshëm deri më 31 maj dhe më 30 gusht 2022, ndërsa më 30 gusht 2022 është sjellë vendim për anulimin e normës së doganës prej 20% dhe 15% për qumështin dhe ajkën (të pakoncentruar dhe pa sheqer të shtuar ose substanca të tjera ëmbëlsuese me një përmbajtje yndyre në masë që tejkalon 21% por jo më shumë se 45% dhe të pakoncentruar dhe pa sheqer të shtuar me një përmbajtje yndyre në masë mbi 10%, por jo më shumë se 45% në ambalazh, masa neto e të cilave nuk i kalon respektivisht 2,5 kilogramë), e vlefshme deri në fund të vitit. Në të njëjtën kohë, më 6 tetor 2022, Qeveria solli vendim për ndërprerjen e vlefshmërisë së vendimit për kufizimin e eksportit të grurit dhe farave të grurit, miellit dhe farave të lulediellit, për të përmbushur detyrimin nga Marrëveshja për mekanizmat e sigurisë ushqimore në Ballkanin Perëndimor, që do të thotë se nuk ka ndalim për tregtimin e produkteve bazë bujqësore dhe ushqimore.

³⁰ Qeveria e RMV, më 9 shtator 2022, solli vendim sipas të cilit marzhi më i lartë tregtar i energjisë elektrike për të gjitha shoqëritë tregtare dhe tregtarët individualë që kryejnë tregti në tregun me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike është vendosur maksimalisht 10%. Masë që është planifikuar të zgjasë gjatë sezonit të ngrohjes, pra deri më 15 prill 2023, ndërsa më 30 tetor 2022 është sjellë vendim sipas të cilit kompanitë që prodhojnë produkte ushqimore bazë, si vaj për gatim, bukë dhe produkte furre, mielli, qumështi dhe produktet e qumështit dhe mishi, do të lejohen të furnizohen me energji elektrike me çmim të subvencionuar prej 80 euro për megavat/orë, për periudhën kohore sa zgjat gjendja e krizës në furnizimin me energji elektrike, duke filluar nga dhjetori 2022

shprehura në euro edhe më tej shënojnë rritje të përshpejtuar vjetore, ndërsa në të njëjtën rritje të mëtejshme të çmimeve të shitjes së prodhuesve vendas të ushqimeve³¹.

Çmimet e energjisë në tremujorin e katërt janë më të larta me 23.6% në bazë vjetore, që paraqet një ngadalësim të caktuar të rritjes (25.5% në tremujorin paraprak). Kjo dinamikë është rezultat i rritjes së ngadaltë të çmimeve të brendshme të derivateve të naftës, në kushtet e një tendence rënëse të çmimit bruto të naftës në bursat botërore dhe me një farë mbiçmimi të dollarit amerikan. Rritja e çmimit të brendshëm të energjisë elektrike për familjet ka mbetur në nivelin e tremujorit paraprak, pas rritjes rregullore në korrik dhe efektit të transferimit të çmimeve të rritura në fillim të vitit³². Në kuadër të komponentit energjetik, çmimet e lëndëve djegëse të ngurta patën rritje më intensive në tremujorin e katërt, pavarësisht masave të miratuara për kufizimin e marzhit të eksportit dhe tregtimit të druve të zjarrit dhe peletit³³, si dhe çmimet e ngrohjes qendrore janë gjithashtu më të larta, pas rritjeve rregullore në janar dhe gusht³⁴.



Në tremujorin e katërt të vitit 2022, pas një periudhe pak më shumë se dy vjeçare, vërehet një ngadalësim i rritjes së **çmimeve për prodhimin e produkteve industriale**, i cili mbetet në një nivel të lartë prej 21.9% në bazë vjetore³⁵ (25.1% në tremujorin paraprak). Kjo dinamikë është kryesisht pasojë e rritjes së ngadaltë të çmimeve të prodhimit të energjisë dhe produkteve të tjera të ndërmjetme. Nga pikëpamja strukturore, çmimet më të larta të prodhimit të energjisë elektrike dhe produkteve ushqimore janë ende nxitës të rritjes së çmimeve për prodhuesit industrialë. **Rritjen më të ngadaltë vjetore shënuan edhe prodhimi i energjisë dhe mallrave të konsumit**, si

³¹ Të dhënat për çmimet e shitjeve të prodhuesve vendas të ushqimeve dhe çmimet e huaja efektive të ushqimeve i referohen dy muajve të parë të tremujorit të katërt 2022.


³² Në përputhje me vendimet e Komisionit Rregullator për Energji (KRE), çmimi i energjisë elektrike për furnizuesin universal "EVN HOME" SHPK Shkup është rritur për 9,48% në janar dhe mesatarisht 9,9% në korrik 2022 (tarifa e ulët për 8.8%, dhe tarifa e lartë mesatarisht për 10.4%). Madje, nga 1 korrik, KRE për herë të parë prezantoi tarifimin e shkallëzuar për konsumin në tarifën e lartë, pra prezantoi një model me tarifa 4 bllok. Krahasuar me tarifën e mëparshme të vetme të lartë, çmimi i energjisë elektrike për bllokun 1 është më i lartë me 5.5%, blloku 2 me 10.3%, blloku 3 me 18.3% dhe blloku 4 me 138.7 (<https://www.erc.org.mk/>). Efekti i transferimit të çmimeve të rritura në janar 2022 rezulton nga ndikimi kompensues i uljes së normës së TVSH-së nga 18% në 5% në rritjen e rregullt të çmimit të energjisë elektrike për familjet në korrik 2021, përkatësisht bazë krahasuese më e ulët.

³³ Qeveria e RMV-së, më 20 korrik 2022, mori vendim që të kufizojë eksportin e druve të zjarrit dhe peletave deri në fund të vitit, me qëllim parandalimin dhe evitimin e pasojave të shkaktuara nga kërkesa në rritje e popullatës për dru zjarri, të shkaktuar nga kriza globale e energjisë. Gjithashtu, më 11 gusht, Qeveria ka marrë vendim për përcaktimin e marzhit më të lartë tregtar në tregtinë me pakicë të druve të zjarrit dhe peletave, në masën maksimale 10%, për të mbrojtur konsumatorët nga rritja e pakontrolluar e çmimeve të produkte të drurit për zjarr, me vlefshmëri deri në fund të vitit.

³⁴ Sa i përket ngrohjes qendrore, çmimi final i energjisë termike të furnizuar është rritur mesatarisht për 14,05% në janar për tri kompanitë në territorin e qytetit të Shkupit, ndërsa në gusht për 14,18% për konsumatorët e furnizuar nga BEG (<https://www.erc.org.mk/>).

³⁵ Analiza e çmimeve të prodhimit të produkteve industriale dhe e çmimeve të prodhimit të energjisë dhe produkteve të konsumit i referohet dy muajve të parë të tremujorit të katërt të vitit 2022.

kategori përmbljedhëse dhe një nga faktorët që ndikojnë në dinamikën e çmimeve të konsumit, shënojnë gjithashtu rritje vjetore dhe arrin 20,9% (23.4% në tremujorin paraardhës). Madje, ndikimi i drejtpërdrejtë i çmimeve të prodhimit të energjisë në inflacion ka qenë i kufizuar, duke marrë parasysh rritjen më të moderuar rregullatore të çmimit të energjisë elektrike për familjet në janar dhe korrik 2022. **Inflacioni i huaj efektiv**³⁶, i tregues tregues i inflacionit të importuar, shënoi stabilizim të rritjes, i cili është 10.7%. **Shpenzimet nominale të punës për njësi produkti** në tremujorin e tretë shënuan një rritje prej 9.8% me bazë vjetore, që paraqet një përshejtim të caktuar krahasuar me rritjen vjetore të arritur të tremujorit të fundit (6.4%)³⁷.



Në tremujorin e katërt 2022 ka vijuar tendenca **e stabilizimit të rritjes së çmimeve të banesave** të matura nëpërmjet indeksit hedonik³⁸ të cilat janë më të larta për 20.6% me bazë vjetore (21.2% në tremujorin paraprak). Nga pikëpamja e ofertës, në tremujorin e tretë vazhduan tendencat e favorshme në raport me vlerën e objekteve të banimit të ndërtuara, me një rritje vjetore prej 15.1%, ndërkohë që të dhënat e disponueshme për vlerën e miratimeve të dhëna për ndërtimin e objekteve të banimit. në tremujorin e katërt³⁹ për momentin, tregojnë për një rënie të mëtejshme të përshejtuara vjetore, në një bazë të lartë krahasuese. Nga aspekti i kërkesës për banesa, ajo edhe më tej është e mbështetur nga aktiviteti kreditor, ashtu që rënie vjetore stabile të kredive banesore⁴⁰.


³⁶ Përllogaritja e inflacionit të huaj efektiv është nxjerrë nga shuma e ponderuar e indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve, partnerët më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të mallrave të konsumit të gjerë. Struktura e ponderimit bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili prej vendeve në totalin e importit nominal në periudhën 2016-2018. Në përllogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia, Serbia, Polonia dhe Spanja. Të dhënat i referohen dy muajve të parë të tremujorit të katërt të vitit 2022.

³⁷ Të dhënat janë llogaritje të brendshme të Bankës Popullore dhe duhet të interpretohen me kujdes. Gjegjësisht, sipas Regjistrimit të popullsisë, familjeve dhe banesave të vitit 2021, ka pasur një ndërprerje strukturore në seri për numrin e të punësuarve në tremujorin e parë të vitit 2022. Për të vazhduar me një analizë konsistente, është bërë një rregullim i të dhënave zyrtare për numrin e të punësuarve.

³⁸ Indeksi hedonik i çmimeve të banesave, i përgatitur nga BPRMV mbi bazën e shpalljeve për shitje në kryeqytet, i publikuar nga agjencitë që merren me shitjen e pasurive të patundshme. Çmimi i banesave është në funksion të sipërfaqes, lagje në të cilën gjendet, vllë banesa a ka ngrohje qendrore dhe a është banesa e re.

³⁹ Analiza i referohet muajit të parë të tremujorit të katërt 2022.

⁴⁰ Të dhënat e disponueshme për dy muajt e parë të tremujorit të katërt 2022.



1.5.2. Pritjet inflacioniste

Përsa i përket ecurisë së normës së inflacionit në periudhën e ardhshme, institucionet vendase dhe ndërkombëtare presin një stabilizim gradual dhe prirje rënëse të çmimeve të konsumit në dy vitet e ardhshme. Krahasuar me projeksionet e mëparshme, ato janë më të larta, kryesisht për shkak të faktorëve në kahun e ofertës dhe nivelit të lartë të çmimeve të produkteve parësore, me pritshmëri për një rritje më të moderuar të aktivitetit ekonomik, si në nivel global ashtu edhe në atë vendas. Në të njëjtin drejtim janë edhe pritjet e analistëve ekonomikë të anketuar të shprehura në anketën **për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale**⁴¹, të kryer në muajin dhjetor, sipas të cilit ata parashikojnë një normë inflacioni prej 7.8% në vitin 2023 dhe 4.3% në vitin 2024 (në shtator pritej një normë inflacioni prej 7.1% në vitin 2023 dhe 4.4% në vitin 2024).

Projektimet dhe parashikimet për normën e inflacionit

	2022	2023	2024
Analistë ekonomik	14.8	7.8	4.3
FMN-ja	12.9	7.1	2.5
Consensus Forecast	14.0	9.4	/
Ministria e Financave	12.9	7.1	2.5
BPRMV	14.3	8,0-9,0	2.4

Burimi: Anketa për parashikimet inflacioniste dhe parashikimet për lëvizjen e PBB-së reale, dhjetor 2022; Raporti i FMN-së, Kërkesë për marrëveshje në pajtim me linjën për kujdesin dhe likuiditetin, nëntor 2022; Consensus Forkast, dhjetor 2022; Ministria e Financave, Strategjia fiskale e rishikuar për vitin 2023-2025 (me perspektiva deri 2027), dhjetor 2022; dhe BPRMV, tetor 2022.


Të njëjtën tendencë tregojnë edhe pritshmëritë afatshkurtra të konsumatorëve dhe drejtuesve të kompanive për lëvizjet e çmimeve të shprehura në anketën e tremujorit të katërt 2022. Kështu, sipas **"pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve gjatë 12 muajve të ardhshëm"**⁴², rruga e parashikuar rënëse e çmimeve pasqyron numrin më të madh të njerëzve që besojnë se 12 muajt e ardhshëm do të kenë një rënie ose çmime të pandryshuara, në krahasim me numrin e njerëzve që presin çmime më të larta. Nga këndvështrimi i pritshmërive në sektorin e korporatave ⁴³, në tremujorin e katërt raporti i drejtuesve të kompanive që presin rritje të çmimeve të produkteve të tyre në tre muajt e ardhshëm në të gjitha aktivitetet është ulur, me çka pritshmërië

⁴¹ Duke filluar nga tetori 2017, BPRMV bëri një ndryshim hulumimin anketues të deritanishëm "Anketa për pritjet e inflacionit". Hulumtimi anketues i ri "Anketa mbi pritjet inflacioniste dhe pritjet mbi lëvizjen e PBB-së reale" realizohet në mostër të analistëve ekonomikë, ndërsa është zgjeruar edhe lënda e Anketës, në pajtim me praktikën e Bankës Qendrore Evropiane (BQE).

⁴² Anketa e Komisionit Evropian mbi optimizmin e konsumatorëve që nga dhjetori 2022.

⁴³ Anketa e trendeve të biznesit të Komisionit Evropian në industri, tregti me pakicë, ndërtimtari dhe sektorin e shërbimeve përfundimisht dhjetori 2022.

në ndërtimtari mbesin disi të pafavorshme krahasuar me ata të tregtisë së vogël, industrinë përpunuese dhe sektorin e shërbimit.



1.6. Bilanci i pagesave

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, llogaria rrjedhëse shënoi një suficit prej 0.6% të PBB-së, i cili është më i ulët me 0.4 pp. të PBB-së krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Ulja e suficitit vjen si pasojë e deficitit më të lartë në këmbimin e mallrave, i cili vjen kryesisht si rezultat i rritjes së deficitit në bilancin e energjisë. Rritja e importit të pajisjeve dhe makinerive funksionon në të njëjtin drejtim, gjë që shkaktoi rritje të bilancit negativ edhe në komponentin joenergjetik. Ndryshimet në komponentët e tjerë të llogarisë rrjedhëse shënuan ndryshime pozitive në bazë vjetore dhe ndikuan në drejtim të përmirësimit të bilancit të llogarisë rrjedhëse. Kështu, i rëndësishëm është kontributi i suficitit të shtuar në shkëmbimin e shërbimeve me përmirësimin e arritjeve të eksporteve në shumicën e kategorive të shërbimeve, si dhe rritja e flukseve neto nga transfertat private, me deficit të pandryshuar të të ardhurave parësore. Llogaria financiare në tremujorin e tretë regjistroi flukse hyrëse mbi bazë neto, si rezultat i flukseve hyrëse neto të realizuara në investimet e portofolit, investimet direkte, kreditë dhe në një masë më të vogël në kreditë tregtare. Rezervat valutore mbetën në zonën e sigurt gjatë kësaj periudhe.





	2021						2022				2021						2022			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	I-IX	I-XII	Tr.1	Tr.2	Tr.3	I-IX	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	I-IX	I-XII	Tr.1	Tr.2	Tr.3	I-IX
	Në miliona euro										% nga PBB-ja									
I. Llogaria rrjedhëse	-41.5	-102.9	110.6	-332.6	-33.8	-366.4	-399.8	-247.1	80.5	-566.4	-0.4	-0.9	0.9	-2.8	-0.3	-3.1	-2.9	-1.8	0.6	-4.1
Mallra dhe shërbime, neto	-311.9	-435.5	-362.7	-764.5	-1110.0	-1874.5	-680.7	-737.8	-554.4	-1972.9	-2.7	-3.7	-3.1	-6.5	-9.5	-16.0	-4.9	-5.3	-4.0	-14.1
Eksport	1799.8	1905.2	2002.3	2036.6	5707.3	7743.9	2139.8	2418.6	2546.6	7105.0	15.4	16.3	17.1	17.4	48.8	66.2	15.3	17.3	18.3	51.0
Import	2111.6	2340.6	2365.0	2801.1	6817.3	9618.4	2820.5	3156.4	3101.0	9077.9	18.1	20.0	20.2	24.0	58.3	82.3	20.2	22.6	22.2	65.1
Mallra, neto	-504.3	-564.1	-504.6	-797.3	-1573.0	-2370.3	-850.3	-899.4	-879.0	-2628.6	-4.3	-4.8	-4.3	-6.8	-13.5	-20.3	-6.1	-6.4	-6.3	-18.9
Shërbimet, neto	192.5	128.6	141.9	32.9	463.0	495.9	169.6	161.6	324.6	655.7	1.6	1.1	1.2	0.3	4.0	4.2	1.2	1.2	2.3	4.7
Të hyrat primare, neto	-128.8	-133.6	-128.7	-130.2	-391.1	-521.3	-149.6	-147.7	-149.3	-446.6	-1.1	-1.1	-1.1	-1.1	-3.3	-4.5	-1.1	-1.1	-1.1	-3.2
Të hyrat sekundare, neto	399.2	466.2	602.0	562.0	1467.4	2029.4	430.5	638.4	784.2	1853.1	3.4	4.0	5.1	4.8	12.6	17.4	3.1	4.6	5.6	13.3
II. Llogaria kapitale	0.2	2.5	0.0	4.4	2.7	7.1	0.2	-0.6	-1.1	-1.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditim neto (+) / debitim neto (-) (zëri përmblendës nga llogaria rrjedhëse dhe kapitale)	-41.3	-100.4	110.6	-328.1	-31.1	-359.2	-399.6	-247.7	79.4	-567.9	-0.4	-0.9	0.9	-2.8	-0.3	-3.1	-2.9	-1.8	0.6	-4.1
III. Llogaria financiare	-643.9	-177.3	633.8	-251.2	-187.4	-438.6	-22.7	-82.2	-523.5	-628.4	-5.5	-1.5	5.4	-2.1	-1.6	-3.8	-0.2	-0.6	-3.8	-4.5
Investime direkte	21.8	-206.4	-13.8	-189.1	-198.4	-387.5	-120.8	-150.1	-179.6	-450.4	0.2	-1.8	-0.1	-1.6	-1.7	-3.3	-0.9	-1.1	-1.3	-3.2
Investime të portofolit	-636.9	8.6	477.4	34.9	-150.9	-115.9	26.4	69.1	-221.7	-126.2	-5.4	0.1	4.1	0.3	-1.3	-1.0	0.2	0.5	-1.6	-0.9
Valuta dhe depozita	27.6	119.7	146.7	139.1	293.9	433.1	24.3	119.0	135.0	278.3	0.2	1.0	1.3	1.2	2.5	3.7	0.2	0.9	1.0	2.0
Kreditë	-19.1	-147.2	17.9	-100.5	-148.5	-248.9	53.6	-34.8	-175.0	-156.2	-0.2	-1.3	0.2	-0.9	-1.3	-2.1	0.4	-0.2	-1.3	-1.1
Kreditë tregtare dhe avanset	-38.3	48.0	5.2	-135.7	14.9	-120.8	-5.4	-81.8	-82.2	-169.4	-0.3	0.4	0.0	-1.2	0.1	-1.0	0.0	-0.6	-0.6	-1.2
Llogari të tjera për arkëtim/pagesa	1.1	0.0	0.4	0.3	1.6	1.9	-0.3	0.0	0.0	-0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
IV. Të drejta të veçanta të tërheqjes (krijimi i detyrimeve neto)	0.0	0.0	163.4	0.0	163.4	163.4	0.0	0.2	0.4	0.6	0.0	0.0	1.4	0.0	1.4	1.4	0.0	0.0	0.0	0.0
V. Gabime dhe lëshime neto (pa rezerva valutore)	8.9	17.6	26.3	9.1	52.8	61.9	3.4	32.8	51.1	87.3	0.1	0.2	0.2	0.1	0.5	0.5	0.0	0.2	0.4	0.6
VI. Rezervat valutore	611.5	94.5	-333.5	-67.9	372.6	304.7	-373.5	-132.7	654.0	147.8	5.2	0.8	-2.9	-0.6	3.2	2.6	-2.7	-1.0	4.7	1.1

Burimi: BPRMV-ja.

1.6.1. Llogaria rrjedhëse


Në tremujorin e tretë të vitit 2022, llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave shënoi suficit në vlerën 80.5 milionë euro, ose 0.6% e PBB-së⁴⁴. Rritja e deficitit tregtar ndikoi në uljen e suficitit të llogarisë rrjedhëse në bazë vjetore (me 0,4 pikë përqindjeje të PBB-së), përkundër lëvizjeve të favorshme të komponentëve të tjerë që ndikuan në drejtim të përmirësimit të bilancit të llogarisë rrjedhëse me duke kompensuar pjesërisht deficitin më të lartë tregtar. Bilanci negativ në shkëmbimin e mallrave lidhet kryesisht me importet neto të energjisë, duke reflektuar pjesërisht rritjen e çmimeve të importit nën ndikimin e çmimeve të larta të bursës të energjisë, si rezultat i situatës së zgjatur të luftës në Ukrainë. Me të njëjtin intensitet, në të njëjtin drejtim ka vepruar edhe rritja e bilancit negativ në kategoritë e produkteve joenergjetike, që është reflektim i rritjes së importit të pajisjeve dhe makinerive. Realizimet e komponentëve të tjerë të llogarisë rrjedhëse kanë qenë më të favorshme në bazë vjetore. Njëkohësisht, një kontribut të rëndësishëm pozitiv ka shënuar rritja e suficitit në shkëmbimin e shërbimeve, e nxitur nga ecuria më e mirë e eksporteve në shërbimet e biznesit, shërbimet kompjuterike, shërbimet e përfundimit të mallrave, si dhe udhëtimet. Ndonëse me një kontribut më të vogël, rritja e flukseve neto në të ardhurat dytësore ka vepruar në të njëjtin drejtim në kushtet e rritjes së transfertave private. Bilanci i të ardhurave parësore është pothuajse i pandryshuar në bazë vjetore.

⁴⁴ Për llogaritjet përdoret shuma e parashikuar e PBB-së nominale (në tetor 2022).



Shtojca 1: Shkëmbimi i tregtisë së jashtme të mallrave dhe lëvizja e kursit efektiv nominal dhe real të këmbimit (NEDK dhe REDK)⁴⁵

Këmbimi tregtar i jashtëm në tremujorin e tretë të vitit 2022 arrin në 5.083,9 milionë euro, ose 36,5% e PBB-së, që krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë paraqet një rritje prej 1.030,9 milionë euro, ose 1,8 p.p. nga PBB-së. Rritja e lartë vjetore e këmbimit tregtar të ekonomisë vendase me vendet e huaja prej 25,4% vjen si pasojë e rritjes si të komponentit të eksportit ashtu edhe të importit, e nxitur kryesisht nga lëvizjet rritëse të çmimeve në bursë të produkteve parësore, paragjithash të çmimeve të energjisë dhe ushqimit në këtë periudhë.




Në tremujorin e tretë të vitit 2022, eksporti i mallrave shënoi një rritje prej 19,9% në bazë vjetore. Kontributi kryesor pozitiv në ecurinë e eksporteve në këtë periudhë është eksporti i produkteve kimike, i cili përfaqëson një kategori të konsiderueshme eksporti të një pjese të kapaciteteve prodhuese të industrisë automobilistike. Rritja e çmimeve të energjisë vazhdoi me ritme dukshëm më të larta në tremujorin e tretë të vitit 2022 dhe pati një ndikim të madh në rritjen e eksporteve të energjisë elektrike si dhe të derivateve të naftës. Më tej, në drejtim të rritjes së eksporteve kanë vepruar edhe eksporti i automjeteve rrugore, makinerive dhe pajisjeve elektrike dhe eksporti i mobiljeve, si kategori eksporti të kompanive të huaja nga sektori i automobilave. Nga ana tjetër, ulja e eksportit të hekurit dhe çelikut, si dhe të pajisjeve dhe makinerive industriale kanë një kontribut negativ në rritjen e eksporteve në tremujorin e tretë të vitit 2022. **Importi i mallrave në tremujorin e tretë 2022 u rrit në 29.5% me bazë vjetore.** Në të njëjtën kohë, analiza sipas produkteve tregon se importi i energjisë ka kontributin më të madh dhe shpjegon afro 40% të rritjes së komponentit të importit. Në fakt, rritja e importit të energjisë, veçanërisht e energjisë elektrike dhe derivateve të naftës, është kryesisht për shkak të çmimeve të larta të importit sipas lëvizjeve të

⁴⁵ Sipas Metodologjisë për këmbim të tregtisë së jashtme, të dhënat për eksportin e mallrave publikohen në f.o.b., kurse për importin e mallrave në c.i.f. - baza


bursave botërore, ndërsa në të njëjtën kohë sasive më të ulëta të importit të energjisë elektrike dhe rritjes së vogël sasiore të derivateve. Kontribut pozitiv në rritjen e importeve në tremujorin e tretë të vitit kanë pasur rritja e importit të metaleve me ngjyra, rritja e importit të pajisjeve dhe makinave, si dhe importi i produkteve kimike. Nga ana tjetër, ulja e importeve të industrisë së përpunimit të metaleve ka vepruar në drejtim të uljes së importeve të hekurit, çelikut dhe xehes. **Arritjet në të dy komponentët e tregtisë së jashtme në tremujorin e tretë të vitit 2022 çuan në një zgjerim të deficitit tregtar me 39% në bazë vjetore, në kushte të zgjerimit të deficitit të saldoshës energjetike dhe atij joenergjetike.**

Të dhënat më të fundit të disponueshme për periudhën tetor-nëntor 2022 tregojnë rritje të mëtijshme të komponentëve të eksportit dhe importit të tregtisë së jashtme në raport me të njëjtën periudhë të një vitit paraprak. Rritja vjetore e eksporteve është 24%, e cila kryesisht rezulton nga rritja e eksporteve të produkteve kimike, ndërsa në pjesë më të vogël nga importi i rrymës elektrike në këtë periudhë. Nga ana tjetër, një kontribut negativ ka eksporti i pajisjeve dhe makinerive, si dhe ai i hekurit dhe çelikut. Importet shënuan një rritje vjetore prej 22,9%, në pjesë më të madhe të nxitura kryesisht nga importet më të larta të energjisë, më konkretisht të derivateve të naftës dhe gazit natyror, su dhe importi i metalit të ngjyrosur, pajisjeve dhe makinave.




Sipas analizës së importit të mallrave nga aspekti i ndarjes sipas Sistemit të llogarive kombëtare (System of national accounts-SNA), rritja e importeve në tremujorin e tretë të vitit 2022 rezulton nga importi i produkteve të ndërmjetme dhe nga importi i energjisë. Nga pikëpamja e importeve të destinuara për konsum personal⁴⁶, kontributin më të madh në rritjen e kësaj kategorie e ka importi i ushqimeve dhe pijeve (të përpunuara) kryesisht për përdorim në familje, në kushtet e një kontributi të konsiderueshëm edhe të importit të mallra për konsumin të gjerë të papërmendura në ndonjë vend tjetër. E analizuar sipas dinamikës, importet për konsum personal shënuan një ngadalësim të moderuar vjetor në tremujorin e tretë dhe nuk tregojnë ende për presione të konsiderueshme mbi totalin e importeve.

⁴⁶ Importet e mallrave për konsum personal analizohen si importe të destinuara për konsum personal, të përafëruara me importet e mallrave të konsumit të gjerë dhe importet e vlerësuar të automjeteve transportuese për përdorim individual.





Analiza e këmbimit tregtar të jashtëm sipas partnerëve tregtarë tregon se në tremujorin e tretë të vitit 2022 Bashkimi Evropian është partneri më i rëndësishëm tregtar i ekonomisë vendase, me pjesëmarrje prej 59,5% në totalin e tregtisë së jashtme. Analiza tregon se rritja vjetore në tremujorin e tretë ishte e shpërndarë në disa vende. Në anën e eksporteve, kontributin më të madh e ka eksporti drejt Gjermanisë, i cili më së shumti i detyrohet eksportit të produkteve të ndryshme të industrisë kimike. Ndikim pozitiv kanë edhe eksportet më të larta të energjisë në Greqi dhe Serbi, eksportet e hekurit dhe çelikut në Greqi dhe Itali, eksportet më të larta të produkteve të ndryshme të industrisë kimike në Serbi dhe eksportet më të larta të automjeteve në Itali. Sipas të dhënave për partnerët tregtarë nga ana e importeve, importet nga Greqia kanë një kontribut pozitiv, që vjen kryesisht nga importet më të larta të energjisë nga ky vend. Rritja e importit të metaleve të çmuara është arsyeja kryesore e rritjes së importit nga Britania e Madhe, me import më të madh të energjisë nga Bullgaria, si dhe importi më i madh i pajisjeve dhe makinave nga Kina. Në lidhje me saldon në tregtinë e jashtme nga partnerët individualë, deficitin tregtar më të lartë në bazë vjetore është më së shumti për shkak të saldove negative më të lartë në këmbimin me Kinën, Greqinë dhe Britaninë e Madhe dhe në një masë më të vogël përkeqësimi i saldove në shkëmbimin me Bullgarinë, Turqinë dhe Rusinë. Gjithashtu, një deficit i vogël është realizuar në këmbimin me Finlandën, krahasuar me suficitin në të njëjtin tremujor të vitit paraprak. Nga ana tjetër, suficit më i lartë është arritur në këmbimin me Gjermaninë, Kosovën dhe Spanjën, por edhe deficit më të ulët me Ukrainën, Romaninë dhe Serbinë, krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar.

Eksporti i mallrave, sipas vendeve, në tremujorin e tretë të vitit 2022 (pjesëmarrje, në%)





Importi i mallrave, sipas vendeve, në tremujorin e tretë të vitit 2022 (pjesëmarrje, në%)






Nga aspekti i treguesve të konkurrueshmërisë së çmimeve, në tremujorin e tretë të vitit 2022, janë vërejtur lëvizje divergjente të treguesit në bazë vjetore. Më konkretisht, kursi real efektiv i këmbimit i deflatuar me shpenzimet e jetesës është mbiçmuar me 2.7% në bazë vjetore, ndërsa indeksi i deflatuar me shpenzimet e mallrave industriale është nënçmuar me 5%. Arritje të tilla janë reflektim i ndryshimeve të çmimeve relative, pra rritjes së shpenzimeve relative të jetesës me 2.7% dhe rënies së çmimeve relative të prodhuesve të produkteve industriale me 5% në bazë vjetore. Nga ana tjetër, kursi nominal efektiv ka mbetur i pandryshuar në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me lëvizje mbiçmimit të rublës ruse, të kompensuar nga zhvlerësimi i lirës turke në raport me denarin.



Sipas analizës së lëvizjeve në indekset e REDK-së të llogaritura me ponder të bazuara në këmbimin e tregtisë së jashtme pa produkte parësore, në tregues të ndryshëm janë vërejtur lëvizje divergjente në baza vjetore. Konkretisht, REDK-ja në bazë të shpenzimeve të jetesës shënoi një mbiçmim prej 6.3% në bazë vjetore, ndërsa REDK-ja e bazuar në çimet e prodhuesve të produkteve industriale u zhvlerësua për 3.8% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në të njëjtin drejtim kanë vepruar edhe lëvizjet e çmimeve relative, pra rritja e shpenzimeve relative të jetesës me 2.2% dhe ulja e çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale me 7.4% në bazë vjetore. Madje, kursi efektiv nominal i këmbimit mbiçmohet me 4%, që vjen si pasojë e nënçmimit të lirës turke në raport me denarin.

Për sa i përket konkurrueshmërisë së çmimeve për periudhën tetor-nëntor 2022, REDK e defluar nga shpenzimet e jetesës shënoi një mbiçmim vjetor prej 4.7%, ndërsa indeksi i bazuar në shpenzimet e prodhuesve industrialë u ul me 1,9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Në të njëjtin drejtim janë edhe lëvizjet e arritura në indeksin e llogaritur me ponder në bazë të këmbimit të tregtisë së jashtme pa produkte parësore, ndërsa në indeksin e llogaritur me shpenzimet e jetesës ka pasur një mbiçmim prej 6.9% në bazë vjetore dhe një nënçmim prej 2% në indeksin e llogaritur me


prodhuesit e produkteve industriale.



Shtojca 2: Ndikimi i çrregullimeve të tregut të energjisë në llogarinë rrjedhëse të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore dhe të Shteteve Baltike në gjysmën e parë të vitit 2022



Shtojca synon të vlerësojë shkurtimisht efektet e përkeqësimit të kushteve në tregjet globale, kryesisht në tregun e energjisë, në pozicionin e jashtëm të vendeve të rajonit të EQLJ-së⁴⁷. Vlerësimi është bërë duke parë ndryshimet në llogarinë rrjedhëse dhe bilancin tregtar, si një komponent më i ekspozuar ndaj ndryshimeve në kushtet e këmbimit. Lufta në Ukrainë dhe sanksionet kundër Rusisë kanë krijuar pabarazi të reja dhe përkeqësuar ato ekzistuese në ekonominë globale. Në fakt, ngjarjet ushtarake çrregulluan tregjet e produkteve primare, të cilat në kushtet e zinxhirëve të furnizimit të vështirë dhe të ngadaltë dhe rritjes së kërkesës globale pas pandemisë, shkaktuan rritje të çmimeve të produkteve bazë, veçanërisht të theksuar në produktet energjetike. Rritja e lartë dhe e zgjatur e çmimeve të energjisë, veçanërisht gazit natyror dhe energjisë elektrike, shkaktoi një krizë energjetike me një intensitet të paparë në 40 vitet e fundit.

Llogaria rrjedhëse dhe përbërësit e saj, gjysma e parë e 2022, si % e PBB-së (EQL, EJT dhe vendet baltike)




⁴⁷ Në grupin e vendeve të EQLJ-së, Polonia, Sllovenia, Rumania, Çekia dhe Hungaria përfshihen në nëngrupin e vendeve të EQLJ-së. Grupi i vendeve të EJT përfshin Shqipërinë, Bullgarinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kroacinë, Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut. Grupi i vendeve baltike përfshin Lituani, Letoninë dhe Estoninë.

Në gjysmën e parë të vitit 2022, vendet e analizuara realizuan mesatarisht një deficit në llogarinë rrjedhëse prej 2,6% të PBB-së, kryesisht si rezultat i deficitit të realizuar në këmbimin e mallrave. Megjithatë, disa vende karakterizohen nga një bilanc negativ më i lartë se mesatarja e arritur në rajon. Kjo ka të bëjë me disa vendeve të Evropës Juglindore – Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, me deficite prej 6.1%, 4.7dhe 4.7% të PBB, si dhe Rumania dhe Letonia, deficitet e llogarisë rrjedhëse të cilave arrijnë respektivisht në 4.3% dhe 4.2%. Lëvizje të tilla në bilancin e llogarisë rrjedhëse të vendeve në përgjithësi janë nxitur nga deficitet në shkëmbimin e mallrave, i cili në këto vende është mbi mesataren e rajonit.



Duke marrë parasysh goditjen globale të çmimeve të energjisë në vitin 2022, një aspekt kyç i analizës është shqyrtimi i efektit të tij në pozicionet e bilancit tregtar. Në gjysmën e parë të vitit 2022, vendet e analizuara shënuan një deficit mesatar tregtar prej 6% të PBB-së. Zbërthimi i tij tregon se strukturisht, mesatarisht, deficitet joenergjetik është më i lartë se deficitet e bilancit energjetik, përkatësisht 3.2% dhe 2.8% të PBB-së. Përkundrazi, në vetëm Çekia, me një deficit të realizuar në tregtinë e mallrave prej 1% të PBB-së, si rezultat i bilancit pozitiv të komponentit joenergjetik prej 3,3% të PBB-së, me një deficit të realizuar njëkohësisht në bilancin energjetik prej 2.3% të PBB-së.


Bilanci tregtar si % e PBB-së (EQL, EJJ dhe vendet baltike)



Të dhënat e gjashtëmujorit të parë tregojnë diferenca të dukshme në lidhje me pjesëmarrjen e bilancit energjetik dhe joenergjetik në totalin e bilancit tregtar. Kjo

reflekton pjesërisht strukturat e ndryshme të ekonomive dhe rrjedhimisht ndjeshmërinë ndaj këtij lloji të goditjeve. Pësja mesatare e deficitit energjetik në deficitin total në rajon gjatë kësaj periudhe është rreth 46%, por në disa vende është mbi gjysma e bilancit total, duke treguar një cenueshmëri dhe ekspozim më të madh ndaj goditjeve energjetike. Shembuj më karakteristik janë **Sllovenia, Çekia, Hungaria, ku deficitin është ekskluzivisht reflektim i bilancit energjetik, ndërsa bilanci joenergjetik është në suficit.** Më shumë se gjysma e deficitit tregtar shpjegohet me bilancin energjetik në Lituani, Bullgari, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut.


Struktura e bilancit tregtar – pjesa e bilancit energjetik dhe joenergjetik në % (EQL, EJA dhe vendet baltike)



Burimi: Eurostat dhe llogaritjet e veta

Sigurisht, një pamje më e qartë e implikimeve të goditjes energjetike mund të merret përmes analizës dinamike. Në gjysmën e parë të vitit 2022, një përqendrim i deficitit të llogarisë rrjedhëse me bazë vjetore është evident pothuajse në të gjitha vendet (përveç Estonisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë).


Kontributi i komponentëve individualë të llogarisë rrjedhëse në ndryshimin vjetor, gjysma e parë e vitit 2022 (EQL, EJA dhe vendet baltike)



Burimi: FMN dhe llogaritjet e veta

Analiza e komponentëve përbërës të llogarisë rrjedhëse tregon se, mesatarisht për të gjitha vendet, thellimi i deficitit në llogarinë rrjedhëse (me 1.6 p.p. të PBB-së) është pasojë e zgjerimit të deficitit tregtar (me 2.4 p.p. të PBB-së), ndërsa pjesa tjetër e komponentëve ndikojnë në ngushtimin e deficitit në llogarinë rrjedhëse në gjysmën e parë të vitit 2022.

Llogaria rrjedhëse, ndryshimet vjetore në p.p. të PBB-së




Burimi: FMN dhe llogaritjet e veta

Lituania, Serbia dhe Maqedonia e Veriut janë vendet ku ndryshimet në deficitin në llogarinë rrjedhëse devijojnë më shumë nga mesatarja e vendeve të analizuara, ndërsa deficitin në Lituani është zgjeruar me 4 p.p. e PBB-së, dhe në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut u zgjerua përkatësisht me 3.6 p.p. dhe 3.5 p.p të PBB-së. **Madje, këto vende përfshihen në vendet me devijimin më të madh në raport me ndryshimet e deficitit mesatar tregtar për të gjitha vendet, si pasojë e thellimit të deficitit në bilancin energjetik.**

Në gjysmën e parë të vitit 2022, pothuajse për të gjitha vendet është evidente një përkeqësim i bilancit tregtar të mallrave me bazë vjetore.

Bilanci tregtar, energjetik dhe joenergjetik, ndryshime vjetore në p.p. të PBB-së




Burimi: Eurostat dhe llogaritjet e veta

Analiza tregon se, mesatarisht, thellimi i deficitit tregtar midis vendeve të rajonit në bazë vjetore (2.4 p.p. të PBB-së) është ndikuar më së shumti nga rritja e deficitit në bilancin energjetik (1.6 p.p. e PBB-së), ndërsa përkeqësimi i bilancit joenergjetik është më i moderuar dhe arrin në 0,9 p.p. të PBB-së. Kështu, mesatarisht, rreth 64% e ndryshimit të deficitit tregtar në rajon, në gjysmën e parë të vitit 2022, vjen si pasojë e rritjes së bilancit energjetik.

Krahasuar midis vendeve të veçanta, disa ekonomi shënojnë devijime më pak të favorshme, domethënë një kontribut dukshëm më të lartë në bilancin e komponentit të energjisë sesa mesatarja. Ndër to është edhe ekonomia vendase me rritje të deficitit tregtar, e cila është pothuajse tërësisht si pasojë e ndryshimeve në bilancin energjetik, me rritje të neto importeve të energjisë, me bazë vjetore. Disa vende të tjera, përfshirë Rumaninë, Letoninë, si dhe Serbinë dhe Lituani, kanë një kontribut dukshëm të lartë të deficitit energjetik në totalin e bilancit tregtar, me një devijim midis

13 dhe 17 p.p. mbi mesataren për të gjitha vendet e analizuara (64%).



Në përmblendhje, në gjysmën e parë të vitit 2022, llogaria rrjedhëse e shumicës së vendeve të rajonit shënoi një përkeqësim, kryesisht nën ndikimin e ndryshimeve të pafavorshme të deficitit tregtar. Në shumicën e vendeve ndikimi i krizës energjetike është i dukshëm, duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e përkeqësimit të bilancit tregtar është pasojë e zgjerimit të bilancit tregtar të energjisë. Mesatarisht për të gjithë rajonin, deficit i energjetik shpjegon 64% të deficitit tregtar në rritje me bazë vjetore në gjysmën e parë të vitit 2022. Megjithatë, duke marrë parasysh strukturën e ndryshme të ekonomive dhe shkallën e ndryshme të varësisë nga energjia, ky efekt është dukshëm më i theksuar në disa vende, përfshirë edhe ekonominë tonë, duke treguar nevojën për marrjen e masave strukturore që do të ulin cenueshmërinë e pozicioneve të jashtme të ekonomive të këtij lloji të goditjeve.


1.6.2. Llogaria financiare

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, llogaria financiare në bilancin e pagesave regjistroi neto hyrje prej 523.5 milionë euro, ose 3.8% e PBB-së. Realizime të tilla janë rezultat i neto-hyrjeve të realizuara pothuajse në të gjithë komponentët e llogarisë financiare, me përjashtim të kategorisë "valuta dhe depozita", e cila regjistron neto-dalje. Në të njëjtën kohë, flukse hyrëse më të rëndësishme mbi bazën neto janë realizuar në investimet e portofolit, si rezultat i huamarrjes së shtetit nëpërmjet obligacioneve të emetuara në tregun gjerman⁴⁸. Investimet direkte gjithashtu kanë realizuar flukse hyrëse neto në të gjithë komponentët, nga të cilët kontributin më të lartë e kanë flukset hyrëse neto të bazuara në investime në kapitalin personal, të cilat së bashku me fitimin e riinvestuar si komponentë joborxhik dominojnë strukturën e investimeve direkte në këtë tremujor. Flukset hyrëse me bazë neto regjistrohen edhe në kategorinë "kredi" nën ndikimin e aktiviteteve të bankës qendrore për administrimin e rezervave valutores, si dhe në kategorinë "kredi tregtare dhe avance".

⁴⁸ Më datë 29.09.2022, në tregun gjerman u emetua një obligacion ("Namensschuldverschreibungen" – NSV) në vlerën 250 milionë euro me afat maturimi 3 vjet dhe normë interesi Euribor 6-mujore + provizion prej 3.75. %.


Llogaria financiare
(pa rezerva zyrtare, në % nga PBB-ja)


Burimi: BPRMV-ja.

Struktura e llogarisë financiare
(% nga PBB-ja)


Burimi: BPRMV-ja.


Në bazë vjetore, në tremujorin e tretë të vitit 2022, llogaria financiare shënon arritje më të mira, me neto hyrje të realizuara, krahasuar me neto daljet të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, dhe kjo si rezultat i arritjeve më të mira në të gjitha kategoritë individuale. Në të njëjtën kohë, ndryshimet në investimet e portfoliut kanë kontribut në mënyrë pozitive, për sa i përket neto hyrjeve të realizuara në tremujorin e tretë të vitit 2022, në krahasim me neto daljet të vitit të kaluar, si rezultat i shlyerjes së realizuar të detyrimeve në bazë të letrave me vlerë të borxhit të emetuara më në tregjet ndërkombëtare nga shteti. Huatë gjithashtu kanë arritur flukse hyrëse neto, në krahasim me neto daljet të vitit të kaluar, kryesisht si pasojë e zhvlerësimit të sektorit privat. Në investimet direkte, janë regjistruar neto flukse më të larta krahasuar me vitin e kaluar, nën ndikimin e realizimeve më të mira të të gjithë komponentëve, dhe kryesisht të komponentit të borxhit, i cili ka realizuar neto hyrje në këtë tremujor, kundrejt akumulimit më të lartë të mjeteve nga instrumentet e borxhit në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke rezultuar në neto dalje në këtë kategori. Lëvizje të favorshme shënojnë edhe kreditë tregtare për sa i përket neto hyrjeve të realizuara, në krahasim me neto daljet të vitit të kaluar, si dhe valutat dhe depozitat, të cilat kanë neto dalje më të ulëta krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, që vjen si pasojë e pozicionit më të favorshëm të institucioneve depozituese.

Kontribute në ndryshimin vjetor të llogarisë financiare
(në p.p. nga PBB-ja)


Burimi: BPRMV-ja.

Gjendja e rezervave valutore bruto në fund të tremujorit të tretë të vitit 2022 është 3.753,8 milionë euro, që paraqet një rritje prej 637,6 milionë euro krahasuar me tremujorin paraprak. E analizuar përmes faktorëve të ndryshimit, rritja e lartë e rezervave valutore vjen kryesisht nga ndërhyrjet e Bankës Popullore në tregun valutor, ku gjatë këtyre tre muajve u regjistrua një neto-blerje e konsiderueshme, si dhe nga operacionet për menaxhimin e rezervave valutore dhe të transaksioneve në llogari të shtetit⁴⁹.


⁴⁹ Më datë 29.9.2022 u emetua në tregun gjerman një obligacion ("Namensschuldverschreibungen" – NSV) në vlerën 250 milionë euro me afat maturimi 3 vjet dhe një normë interesi Euribor 6-mujore + marzhi prej 3.75%.



Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2022, bruto rezervat valutore arrijnë në 3.862,9 milionë euro. Shikuar nga faktorët e ndryshimit, ndryshimi pozitiv i rezervave valutore në këtë tremujor vjen kryesisht nga transaksione për llogari të shtetit⁵⁰, si dhe nga operacionet për menaxhimin e rezervave valutore dhe ndërrhyrjet e Bankës Popullore në tregun valutor.

1.6.3. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare dhe bruto borxhi i jashtëm


Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2022, pozicioni neto i borxhit të ekonomisë së Maqedonisë arrin në 7.851,1 milionë euro, ose 56,3% të PBB-së⁵¹. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, pozicioni i borxhit neto shënoi një zgjerim prej 0.6 p.p të PBB, në kushtet e rritjes më të lartë të detyrimeve ndërkombëtare në raport me rritjen e mjeteve ndërkombëtare. Nga pikëpamja sektoriale, ndryshimi tremujor rezulton më së shumti nga rritja e detyrimeve neto në sektorët e tjerë (rritja e detyrimeve neto në investimet të drejtpërdrejta), si dhe nga rritja e detyrimeve neto të shtetit, kryesisht si rezultat i rritjes së detyrimeve neto bazuar në letrat me vlerë të borxhit. Nga ana tjetër, rritja e mjeteve neto të bankës qendrore, më konkretisht rritja e mjeteve pas rezervave valutore, ka ndikim pozitiv në drejtim të zvogëlimit të pozicionit neto të borxhit të ekonomisë së Maqedonisë në tremujorin e tretë të vitit 2022.




⁵⁰ Më 23.11.2022 Republika e Maqedonisë së Veriut mori kështu të marrëveshjes PLL të miratuar nga FMN, me vlerë 110 milionë euro.

⁵¹ Në kuadër të analizës, për PBB-në nominale për vitin 2022 janë përdorur projeksionet e prillit të Bankës Popullore. Diferenca më e madhe midis PBB-së nominale të realizuar për vitin 2021 dhe shumës së parashikuar të PBB-së nominale për vitin 2022 është reflektuar në treguesit relative.

Në bazë vjetore, vërehet një ngushtim i pozicionit negativ të investimeve ndërkombëtare me 3.4 p.p. të PBB-së⁵², si rezultat i një zvogëlimit më të madh të detyrimeve ndërkombëtare në raport me rënien e mjeteve ndërkombëtare (përkatësisht me 8,3 p.p. dhe 5 p.p. të PBB-së)⁵³. Nga këndvështrimi sektorial, rënia vjetore ka ardhur kryesisht nga zvogëlimi i neto-detyrimeve të shtetit, me një rënie të neto-detyrimeve bazuar në letrat me vlerë të borxhit të emetuara, si dhe uljes së neto-detyrimeve në sektorë të tjerë (ulje e neto-detyrimeve në bazë të huave financiare dhe investimeve tll drejtpërdrejta). Nga ana tjetër, ulja e neto-mjeteve të bankës qendrore, si dhe rritja e neto-detyrimeve të institucioneve depozituese (kryesisht si rezultat i rritjes së neto-detyrimeve të valutave dhe depozitave) ndikuan në zgjerimin e pozicioni neto të borxhit në tremujorin e tretë të vitit 2022.



Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2022, niveli i bruto borxhit të jashtëm arrin në 11.077,3 milionë euro, ose 79,4% e PBB-së, që paraqet një rritje prej 5,2 p.p. të PBB-së, krahasuar me tremujorin paraprak. Me përjashtim të efektit të aktiviteteve specifike për menaxhimin e rezervave valutore të Bankës Popullore⁵⁴, bruto borxhi i jashtëm arrin në 74.3% të PBB-së dhe shënoi një rritje tremujore prej 3.8 p.p. të PBB, e cila rezultojnë nga rritja e borxhit publik dhe privat, përkatësisht me 1.9 p.p PBB-së. Rritja tremujore e borxhit publik vjen më së shumti si pasojë e rritjes së borxhit të shtetit ndaj vendeve të huaja, si rezultat i rritjes së detyrimeve afatgjata në bazë të letrave me vlerë të emetuara të borxhit. Nga ana tjetër, rritja e borxhit privat vjen kryesisht si pasojë e rritjes së borxhit ndërbankar.





⁵² Në shumatat absolute, pozicioni neto i borxhit të ekonomisë së Maqedonisë në tremujorin e tretë të vitit 2022 shënoi rritje vjetore prej 876,7 milionë euro.


⁵³ Në shumatat absolute, mjetet ndërkombëtare në tremujorin e tretë të vitit 2022 shënuan rënie përkatësisht prej 761,4 dhe 1.638,1 milionë euro.

⁵⁴ Veprimtaritë specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore i referohen repo-marrëveshjeve dhe operacioneve të tjera që lidhen me menaxhimin e rezervave valutore.

Ndryshimi vjetor i bruto borxhit të jashtëm tregon një rënie prej 5.8 p.p. e PBB-së⁵⁵, e arritur në kushtet e rënies së borxhit publik për 6.6 p.p. e PBB-së dhe rritje e borxhit privat me 0.9 p.p. e PBB-së. Ndryshimi i borxhit publik vjen më së shumti si pasojë e uljes së borxhit të shtetit (bazuar në letrat me vlerë të emetuara të borxhit). Nga ana tjetër, kontributin më të madh në rritjen e borxhit privat (rritje të valutave dhe depozitave) e ka rritja e borxhit ndërkompani, njëkohësisht rënie të borxhit privat të sektorit jobankar.



Më 30.09.2022, neto borxhi i jashtëm arriti në 3.635.8 milionë euro, ose 26.1% e PBB-së, që paraqet një rënie tremujore prej 1.7 p.p. të PBB-së, ndërkohë që uli neto-borxhin publik për 2.7 p.p. e PBB-së dhe njëkohësisht rritje të neto borxhi privat për 1 p.p. të PBB-së.



Treguesit për borxhin e jashtëm të ekonomisë së brendshme edhe më tej janë në zonën e sigurt. Treguesi për pjesëmarrjen e bruto borxhit të jashtëm në PBB vazhdon ta klasifikojë ekonominë në grupin e vendeve me borxh të lartë, ndërkohë që të gjithë treguesit e tjerë të aftësisë paguese dhe likuiditetit tregojnë për huamarrje të ulët të vendit. Megjithatë, në strukturën e bruto borxhit të jashtëm, një pjesëmarrje të lartë zënë kreditë tregtare, si formë e financimit të tregtisë së jashtme. Në të njëjtën kohë, pesha e borxhit ndërkompani është gjithashtu e madhe, si një formë e financimit të operacioneve të shoqërive me kapital të huaj. Këta dy komponentë zbutin profilin e rrezikut të pozicionit të borxhit të ekonomisë. Niveli i bruto borxhit të jashtëm, pa përfshirë kreditë tregtare dhe borxhin ndërkompani, arrin në 44.6% të PBB-së⁵⁶, që është tregues i një borxhi të moderuar.

⁵⁵ Në shuma absolute, bruto borxhi i jashtëm në tremujorin e tretë të vitit 2022 shënoi rritje vjetore prej 1001,6 milionë euro, pa përfshirë efektin e aktivitetëve specifike për menaxhimin e rezervave valutore të Bankës Popullore.

⁵⁶ Ka të bëjë me repo-kontratat.



Treguesi i borxhit të jashtëm	Aftësia paguese				Likuiditeti		
	Shlyerja e interesit/ eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera	Borxhi bruto/ eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera	Borxhi bruto/ PBB	Shlyerja e interesit/ eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera	Rezerva valutore/ borxh afatshkurtër	Rezerva valutore/ borxh afatshkurtër, me maturim të mbetur**	Borxh afatshkurtër/ Borxhi total
	në %				raport	raport	në %
31.12.2010	3.2	140.4	59.7	13.9	1.5	1.0	27.9
31.12.2011	3.1	148.4	64.6	16.8	1.8	1.2	25.2
31.12.2012	2.9	142.1	67.6	13.1	1.6	1.0	26.7
31.12.2013	2.5	137.3	67.3	15.8	1.6	1.1	23.3
31.12.2014	3.0	149.1	74.0	17.2	1.8	1.1	22.3
31.12.2015	2.7	143.9	73.2	20.0	1.7	1.1	21.3
31.12.2016	2.4	148.8	79.3	14.8	1.7	1.2	21.9
31.12.2017	2.7	138.6	76.9	12.7	1.3	0.9	23.9
31.12.2018	2.2	130.7	77.3	15.7	1.4	1.0	25.8
31.03.2019	2.0	123.1	74.3	9.0	1.4	1.0	26.0
30.06.2019	2.0	124.4	75.5	9.0	1.4	1.0	26.5
30.09.2019	2.0	128.0	77.3	9.0	1.4	1.0	27.8
31.12.2019	2.0	121.9	76.3	9.0	1.6	1.0	25.6
31.03.2020	1.9	118.9	73.8	13.6	1.4	1.0	26.6
30.06.2020	1.9	125.7	79.4	13.6	1.9	1.2	22.4
30.09.2020	1.9	129.9	80.7	13.6	1.7	1.0	22.9
31.12.2020	1.9	122.3	77.9	13.6	1.9	1.1	20.4
31.03.2021	2.2	127.6	84.3	16.3	1.9	1.2	21.5
30.06.2021	2.2	130.2	86.0	16.3	1.9	1.2	22.0
30.09.2021	2.2	125.9	83.1	16.3	1.8	1.3	22.2
31.12.2021	2.2	126.9	83.8	16.3	1.8	1.3	21.5
31.03.2022	2.0	120.3	81.4	10.4	1.3	1.0	26.0
30.06.2022	2.0	119.6	80.9	10.4	1.2	0.9	26.3
30.09.2022	2.0	126.0	85.2	10.4	1.4	0.9	26.8
Kritere për debitim të moderuar*	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%	1.00		

*Kriteri për debitim të moderuar është marrë sipas metodologjisë së Bankës Botërore për përgaditjen e treguesve të debitimit, e cila nënkupton përdorimin e mesatareve lëvizëse trevjeçare të PBB-së dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve dhe të hyrave tjera, si emërues në llogaritjen e treguesve.

E përgaditur në pajtim me "External debt statistics: Guide for compilers and users", i emëtuar nga FMN-ja.

**Sipas rregullës së Grinspan dhe Guidoti, e nevojshme është që vendi ta ruaj mbulimin e tërë të borxhit afatshkurtër (maturim i mbetur) me rezerva valutore. Borxhi afatshkurtër sipas maturimit të mbetur llogaritet duke shtuar shumën e borxhit të jashtëm (maturimin origjinal), i cili duhet të paguhet në periudhë prej një viti ose më pak, në borxhin e jashtëm afatshkurtër (maturimin origjinal).

Burimi: BPRMV-ja.

II. Politika monetare⁵⁷

Që nga fundi i vitit të kaluar, Banka Popullore ka filluar me normalizimin gradual të politikës monetare, me qëllim ruajtjen e stabilitetit afatmesëm të çmimeve. Kjo u bë nëpërmjet menaxhimit të duhur të likuiditetit si dhe një rritje graduale të normës bazë të interesit duke filluar nga prilli 2022. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, Banka Popullore ka vazhduar me rritjen e normave të interesit, ku norma e interesit për bonot e thesarit është rritur me gjithsej 1.75 p.p. në nivelin 4.75%. Gjatë marrjes së vendimeve, vëmendje e veçantë i është kushtuar lëvizjeve rritëse të inflacionit, i cili vijon të jetë i nxitur kryesisht nga komponentët ushqimorë dhe energjistikë. Megjithatë, efektet e transferuara në çmimet e tjera po bëhen më të theksuara, si dhe janë rritur edhe pritjet inflacioniste, të cilat imponuan nevojën për një reagim të përshtatshëm monetar. Gjithashtu, duke pasur parasysh strategjinë monetare të kursit stabil të denarit në raport me euron, ndryshimet në politikën monetare të brendshme pasojnë


⁵⁷ Informata më të detajuara për masat e reja monetare mund të lexoni në faqen e internetit të Bankës Popullore: https://www.nbrm.mk/content/MPI%20publikacij/Hronologjia_na_promenite_vo_postavenosta_na_monetarnite_instrumenti_na_Narodnata%20banka.pdf

edhe ndryshimet në politikën monetare të Bankës Qendrore Evropiane. Ky sistem monetar u mbështet edhe nga masa shtesë, pra nga ndryshimet në instrumentin e rezervës së detyrueshme që synojnë uljen e euroizimit, por edhe nxitjen e kreditimit të projekteve për burimet e rinovueshme të energjisë. Nëpërmjet këtyre masave zvogëlohen presionet në tregun valutor, gjë që është veçanërisht e rëndësishme në kushtet e një regjimi të qëndrueshëm të kursit të këmbimit. Gjatë kësaj periudhe u miratuan masa sistematike, pra u vendos një shtresë mbrojtëse kundërciklike e kapitalit prej 0.5% për periudhën gusht-dhjetor 2023 dhe prej 0.75% për tremujorin e parë 2024 për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe janë futur dispozitat për ekspozimet ndaj vendeve të tjera. Për cilësinë e kërkesës për kredi të personave fizikë janë miratuar edhe instrumente makroprudenciale, të cilat forcojnë më tej mekanizmat mbrojtës në sistemin bankar⁵⁸.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, norma bazë e interesit – norma e interesit në bonot e thesarit të Bankës Popullore, u rrit tre herë me gjithsej 1,75 pikë përqindje, e cila arriti në 4,75%. Ndryshimet në përcaktimin e politikës monetare vazhdojnë të jenë një reagim ndaj inflacionit dhe pritjeve inflacioniste. Ndryshimet në normën bazë të interesit u plotësuan edhe nga një rritje e normave të interesit për depozitat njëditore dhe shtatë ditore, për një total përkatësisht prej 1,75 p.p., në nivelet përkatësisht 2,65% dhe 2,70% në dhjetor 2022. Shuma e ofruar e bonove të thesarit mbeti e pandryshuar në 10.000 milionë denarë, ndërsa vazhdoi edhe aplikimi i ndryshimeve në instrumentin e rezervës së detyrueshme, përmes të cilit nxitet kreditimi i projekteve që kanë të bëjnë me prodhimin vendor të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.


Gjatë tremujorit të katërt, Banka Popullore solli vendim për ndryshimin e normës së rezervës së detyrueshme të bankave, me qëllim stimulimin e mëtejshëm të kursimeve në monedhën vendase. Ndryshimi i këtij instrumenti përfshin një rritje të normës së rezervës së detyrueshme të bankave për detyrimet në valutë nga 18% në 19%. Është rritur edhe pjesa e rezervës së detyrueshme në valutë që bankat plotësojnë në euro, nga 75% në 77%, gjë që forcon efektin e ndryshimit të këtij instrumenti. Pritet që masa do të përforcojë ndryshimet e iniciuara në politikën e interesit të bankave dhe se bankat do të ofrojnë norma më të favorshme të interesit për të gjitha kategoritë e depozitave në denarë, duke kontribuar në rritjen më të fortë të kursimeve në monedhë vendase. Në të njëjtën kohë, ky ndryshim do të kontribuonte në menaxhimin optimal të likuiditetit.

⁵⁸ Informacion më i detajuar mbi masat e reja monetare, përkatësisht mbi ndryshimet në normat e interesit të bonove të thesarit dhe normat e interesit për depozitat njëditore dhe shtatëditore, mbi ndryshimet në instrumentin e rezervës së detyrueshme dhe për futjen e instrumenteve makroprudenciale për cilësinë e kërkesës për kredi nga personat fizik dhe norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të bankave për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për ekspozimet ndaj vendeve tjera mund të lexohen në ueb faqen e Bankës Popullore: <https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-soopstenie-01082022.nspix>; <https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-soopstenie-12102022-1.nspix>; <https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-soopstenie-16112022.nspix>; <https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-soopstenie-14122022.nspix>; <https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-odluka-za-makroprudencnate-instrumenti-za-kvalitetot-na-kreditnata-pobaruvalacka-od-fizickite-lica.nspix>; <https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-visina-na-stapkata-na-protivciklicniot-zastiten-sloj-na-kapitalot.nspix>;




Vlerësimet e arritjeve të treguesve bazë makroekonomikë në ekonominë vendase⁵⁹, treguan se ato janë në pjesën më të madhe brenda projeksionit të fundit të muajit tetor, me devijime të vogla. Në tremujorin e tretë të vitit dolën në pah efektet negative të krizës energjetike dhe rritja e shpenzimeve në sektorë të caktuar të ekonomisë, të cilat çuan në një rritje të ngadaltë ekonomike (2%). Arritjet në tremujorin e tretë të vitit 2022, si dhe për tre tremujorët e parë të vitit (rritje prej 2.7%) janë pak më të mira se sa ishte parashikuar. Të dhënat e disponueshme me frekuencë të lartë për aktivitetin e brendshëm ekonomik në tremujorin e katërt janë të kufizuara, por në mbështetje të pritjeve që rritja do të ngadalësohet deri në fund të vitit. Kështu, të dhënat e muajit tetor tregojnë për një rënie të vogël reale vjetore të qarkullimit në totalin e tregtisë, kundrejt rritjes së vogël në tremujorin paraprak dhe tendencave të mëtejshme të pafavorshme në prodhimin industrial. Norma vjetore e inflacionit në muajin nëntor u ngadalësua në 19.5%, kështu që inflacioni mesatar vjetor në periudhën janar - nëntor 2022 është 13.8%. Megjithatë, rreth 76% e kësaj rritjeje është efekt i drejtpërdrejtë i rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore dhe të energjisë. Megjithatë, rreziqet e efekteve më të forta mbartëse mbi inflacionin bazë nga çmimet e energjisë dhe ushqimeve, të cilat ende ekzistojnë, si dhe pritjet në rritje inflacioniste, bënë të nevojshme një reagim të mëtejshëm monetar. Duke qenë se monedha jonë është e lidhur me euron, në procesin e vendimmarrjes ndikojnë edhe ndryshimet në politikën monetare të Bankës Qendrore Evropiane, e cila pritet të vijoje me rritjen e normave të interesit në periudhën e ardhshme. Pasiguria e dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve parësore në bursa, e veçanërisht të produkteve energjetike, theksohet për shkak të zhvillimeve ushtarake në Ukrainë dhe sanksioneve ndaj Rusisë, prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme të zbatohen politika të kujdesshme të brendshme dhe menaxhim me kujdes të kërkesave të brendshme. Rezervat valutore janë ende në zonën e sigurt dhe niveli i tyre plotëson kërkesat për përshtatshmëri sipas standardeve ndërkombëtare. Tregu i brendshëm valutor është i qëndrueshëm, me lëvizje të mëtejshme të favorshme në tregun valutor dhe me pozitë solide valutore të bankave. Në periudhën tetor-nëntor, Banka Popullore pothuajse nuk ka ndërhyrë në tregun valutor dhe rezervat valutore kanë shënuar rritje të mëtejshme, e cila ka qenë mbi parashikimet për tremujorin e katërt të vitit. Nga pikëpamja e lëvizjeve në totalin e depozitave dhe në totalin e kredisë, të dhënat e muajit nëntor tregojnë se aktiviteti kreditor edhe më tej rritet, por më i moderuar, ndërkohë që rritja e depozitave përshpejtohet, në raport me pritjet nga projeksioni i tetorit.

⁵⁹I referohet informacioneve të disponueshëm gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, të cila janë marrë parasysh gjatë marrjes së vendimeve për përcaktimin monetar në atë periudhë.




Burimi: BPRMV.




Burimi: BPRMV dhe BQE.

Në tremujorin e katërt të vitit 2022, BQE e rriti normën bazë të interesit në nivelin 1.25 p.p. dhe arriti deri në nivelin prej 2.5%. Me këtë, diferenca ndërmjet normës bazë të interesit të Bankës Popullore dhe normës bazë të interesit të BQE-së në fund të dhejtorit 2022 ishte 2.25 p.p. dhe u rrit për 0.5 p.p. në raport me tremujorin paraprak. Për sa i përket normave treguese të interesit të tregut prej 1 milion EURIBOR dhe 1 milion SKIBOR, diferenca ndërmjet tyre u ul me 0.2 p.p. në fund të tremujorit të katërt të vitit 2022, krahasuar me tremujorin paraprak.

Në ekonominë vendase, sa i përket normave të interesit në gjithsej depozitat (në denarë dhe në valutë të huaj), diferenca e interesit në muajin nëntor paksa u rrit në krahasim me tremujorin paraprak dhe arriti në 0,7 p.p., në kushte të rritjes së fortë të normave të interesit për depozitat në denarë, përkatësisht depozitave në valutë. Nga gjithsej depozitat e sapo pranuar⁶⁰ diferenca e interesit në nëntor u rrit dhe arriti në 1,3 p.p., e nxitur nga rritja më e theksuar e denarit se rritja e normave të interesit në valutë, krahasuar me tremujorin paraprak.



Burimi: BPRMV.




Burimi: BPRMV.

⁶⁰Për sa i përket normave të interesit të kredive të reja të miratuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për kreditë e reja të miratuara rrjedh nga fakti se ato kushtëzohen nga vëllimi i kredive të reja të miratuara (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

2.1. Likuiditeti i bankave

Në tremujorin e katërt të vitit 2022, likuiditeti në denarë i bankave ka shënuar rënie, e cila më së shumti rezulton nga ndryshimi i instrumenteve monetare, ndërsa ndryshimi i faktorëve autonomë ka vepruar në drejtim të krijimit të likuiditetit.




Nga këndvështrimi i ndryshimit të instrumenteve monetare, depozitat në dispozicion të bankave në Bankën Popullore në tremujorin e katërt kontribuan në tërheqjen e likuiditetit (për 17.243 milionë denarë), me rritje të plasmaneve në depozitat njëditore (për 15.106 milionë denarë) dhe depozitave 7 ditore (për 2.137 milionë denarë). Gjendja e instrumentit bazë - bonove të thesarit të BPRMV, në fund të tremujorit të katërt arriti në 9.473 milionë denarë⁶¹ dhe shënoi ndryshim në rritje (për 1.151 milionë denarë) në krahasim me fundin e tremujorit paraprak.

Interesi i bankave për plasman të mjeteve të tyre në valutë në një depozitë në valutë pranë Bankës Popullore është rritur me rreth 8 milion euro gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022. Konkreisht, ky instrument për menaxhimin e likuiditetit valutor të bankave u riaktivizua në gjysmën e dytë të vitit 2020, në kushtet e rritjes së pasigurisë në tregjet ndërkombëtare, gjë që u jep bankave në vend mundësinë të investojnë një pjesë të mjeteve të tyre valutore në instrumentet afatshkurtra dhe të besueshme të bankës qendrore.

Faktorët autonome në bazë neto në tremujorin e katërt të vitit 2022 kontribuan në krijimin e likuiditetit në sistemin bankar për 15.893 milionë denarë. Ndryshim i tillë është në pjesë më të madhe si rezultat të transaksioneve të shtetit dhe në pjesë të vogël të inntervenimet valutore të Bankës Popullore, ndërsa parat e gatshme në qarkullim ndikuan në drejtim të uljes së likuiditetit .

⁶¹ Në ankandin e bonove të thesarit të Bankës Popullore, i mbajtur më 14 dhjetor 2022, janë ofruar 10.000 milionë denarë bono thesari, prej të cilave janë shitur 9.473 milionë denarë, me kamatë prej 4.75% dhe me afat maturimi prej 35 ditë.



Në tremujorin e katërt të vitit 2022, bankat në llogaritë e tyre në Bankën Popullore vazhduan të kenë më shumë mjete të ndara se shuma e përcaktuar e rezervës së detyrueshme në denarë, mesatarisht për rreth 4,3%.



III. Lëvizjet në tregjet financiare

Norma e interesit në tregun e depozitave ndërbankare në tremujorin e katërt të vitit 2022 u rrit në bazë tremujore me 0.6 p.p. dhe mesatarisht 2.1%, në kushtet e rritjes së normës bazë të interesit të Bankës Popullore. Gjithashtu, të gjitha kuotimet mesatare të SKIBOR shënuan një lëvizje në rritje. Në tregun primar të letrave me vlerë shtetërore, emetimet e reja ishin kryesisht me afat më të gjatë, ndërsa në tregun sekondar të letrave me vlerë tregtoreshin vetëm letrat me vlerë shtetërore në shumë të vogla. Në Bursën e Maqedonisë, qarkullimi i aksioneve dhe vlera e MBI-10 shënuan rritje tremujore prej 27,0% dhe 1,2%, të ngjashme me lëvizjet e bursave rajonale, ku indekset shënuan rritje të fortë, mesatarisht 9, 2% në bazë tremujore. Në tregjet financiare ndërkombëtare, indekset e ndryshueshmërisë së tregjeve të obligacioneve dhe aksioneve, pra indekset MOVE dhe VIKS, vazhdojnë të tregojnë pasigurinë ende të pranishme në tregjet botërore të kapitalit. Diferencat ndërmjet hyrjeve të eurobonove maqedonase dhe gjermane u ngushtuan në krahasim me tremujorin paraprak, me një rritje më të fortë të hyrjeve të obligacioneve shtetërore gjermane dhe një rritje më të moderuar të hyrjeve të eurobonove maqedonase.

3.1. Tregu ndërbankar me depozita të pasigurta


Në tremujorin e katërt të vitit 2022, norma e intersit mesatar në tregun ndërbankar të depozitave (MBKS) u rrit për 0.3 p.p. krahasuar me tremujorin paraprak ishte 2.1%, në kushtet e rritjes së normës bazë të interesit të Bankës Popullore me 1,75 p.p. (deri në nivelin 4.75%). Tregimi ndërbankar të tregut të depozitave u zvogëluar në tremujorin e katërt dhe arritën në 4.158 milionë denarë (9.697 milionë denarë në tremujorin paraprak), në pjesën më të madhe si rezultat i zvogëlimit të transaksioneve me afat afatizim deri në shtatë ditë, ndërsa në një masë më të vogël edhe i

zvogëlimin e transaksioneve brenda natës dhe deri në një muaj. Në bazë tremujore, të gjitha kotacionet mesatare SKIBOR shënuan një lëvizje në rritje që arriti deri në 0.8 p.p..




3.2. Tregu i letrave me vlerë shtetërore




Gjendja e letrave me vlerë të emetuara shtetërore në tregun primar në tremujorin e katërt të vitit 2022 shënoi rënie për 296 milionë denarë ose 0,2% në bazë tremujore dhe arriti në 153.322 milionë denarë. Analizuar nga aspekti i strukturës së letrave me vlerë shtetërore, obligacionet shtetërore janë ende kategoria dominuese në gjendjen e gjithsej letrave me vlerë shtetërore të emetuara në tregun primar, me një pjesëmarrje prej 77.1%. Gjithashtu, obligacionet shtetërore pesëmbëdhjetëvjeçare vazhdojnë të kenë pjesëmarrje më të lartë në strukturën e maturitetit të letrave me vlerë shtetërore (43.1%), e cila është në përputhje me udhëzimet të strategjisë fiskale të Ministrisë së Financave për emetimin e obligacioneve shtetërore me afat më të gjatë maturimi, me qëllim të optimizimit të pagesave të borxhit dhe zvogëlimit të rrezikut për refinancim. Në tremujorin e katërt, u vu re një rritje tremujore në pjesëmarrjen e obligacioneve shtetërore pesëmbëdhjetëvjeçare dhe boneve shtetërore dymbëdhjetëmuajorepërkatësisht me 1.6 p.p. dhe 0.8 p.p.. Në të njëjtën kohë, ulje ka në pjesëmarrjen e obligacioneve shtetërore dyvjeçare dhe bonove shtetërore tre mujore përkatësisht me 2.4 p.p. dhe 0.1 p.p.. Nga këndvështrimi i strukturës valutoe, letrat me vlerë shtetërore në monedhë vendase pa klauzolë valutoe vazhduan të ruajnë peshën e tyre dominuese, duke përbërë 63.4% të totalit të letrave me vlerë shtetërore (61.1% në tremujorin paraprak). Në aspekt të strukturës së pronësisë, bankat në këtë tremujor ulën pjesëmarrjen e tyre nga 34.9% në 32.9%, në kurriz të rritjes së pjesëmarrjes së investitorëve të tjerë (67.1%). Ndër investitorët e tjerë, fondet pensionale vazhdojnë të jenë më të përfaqësuara (me pjesëmarrje prej 47.0%).⁶²



⁶² Strategjia Fiskale e Rishikuar 2023-2025 (me parashikime deri vitin 2027), Ministria e Financave, Dhjetor 2022.




Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2022, normat e interesit të letrave me vlerë shtetërore, të përcaktuara nga Ministria e Financave, shënuan ndryshime në rritje. Kështu, në tregun primar bonot shtetërore dymbëdhjetëmujore pa klauzolë valutore u emetuan me një normë mesatare të ponderuar interesi prej 3.1% (1.9% në tremujorin paraprak). Gjithashtu, gjatë të njëjtit tremujor janë emetuar obligacione shtetërore pesëmbëdhjetëvjeçare pa dhe me klauzolë valutore me norma mesatare interesi përkatësisht 5.0% dhe 5.2% (përkatësisht 4.2% dhe 4.0% në tremujorin paraprak).




Tregtimi i letrave me vlerë në tregun sekondar në tremujorin e katërt të vitit 2022 u zvogëlua dhe arriti në 8 milionë denarë (1.936 milionë denarë në tremujorin paraprak), ndërsa në këtë segment të tregut janë realizuar vetëm transaksione me obligacione shtetërore. Nga këndvështrimi i afatizimit të transaksioneve me obligacionet shtetërore, u kryen transaksione me afatizim të mbetur nga 5 deri në 10 vjet (me një hyrje mesatare deri në maturim prej 4.3%). Këto ndryshime tregojnë për një rënie të tregtimit në tregun sekondar të letrave me vlerë, e ndjekur nga raporti i likuiditetit⁶³.

⁶³Koeficienti i likuiditetit të tregut sekondar është një raport ndërmjet qarkullimit mesatar ditor dhe gjendjes së letrave me vlerë shtetërore.



Në tregjet financiare të eurozonës në tremujorin e katërt të vitit 2022, kthimet e letrave shtetërore në vlerë 10-vjeçare ishin mesatarisht rreth 2.4% (1.6% në tremujorin paraprak), ndërsa kthimet e obligacionet shtetërore amerikane 10-vjeçare arritën në 3.8% (3.1% në tremujorin paraprak), në kushtet e rritjes së normave të interesit nga Fed dhe BQE në përgjigje të presioneve të rritura inflacioniste, si dhe rreziqeve të theksuara gjeopolitike.^{64,65}




Kthimet e eurobonove maqedonase⁶⁶ në tremujorin e katërt të vitit 2022 shënuan rritje mesatare, me një zhvendosje të njëkohshme por më të përforcuar në rritje të hyrjeve edhe të obligacioneve shtetërore gjermane. Kjo çoi në një zgjerim të diferencave midis këtyre dy obligacioneve, të cilat ishin mesatarisht 3.7 p.p., 4.6 p.p., 4.7 p.p. dhe 4.8 p.p.

⁶⁴ Këto janë obligacione qeveritare gjenerike që rrjedhin nga kurbat e hyrjeve të obligacioneve shtetërore të Gjermanisë dhe Francës.



⁶⁵ Këto janë obligacione qeveritare gjenerike që rrjedhin nga kurbat e hyrjeve të obligacioneve shtetërore të SHBA-së.

⁶⁶ I referohet eurobonove maqedonase të emetuara në korrik 2016, janar 2018, qershor 2020 dhe mars 2021. Eurobonot janë emetuar në një shumë nominale përkatësisht 450 milionë euro, 500 milionë euro, 700 milionë euro dhe 700 milionë euro, me afat maturimi përkatësisht 7, 7, 6 dhe 7 vjet dhe norma vjetore interesi përkatësisht 5,625%, 2,75 %, 3.675% dhe 1.625%.



3.3. Bursat



Në tremujorin e katërt të vitit 2022, vlera e indeksit të bursës së Maqedonisë për aksionet MBI-10 u rrit për 1.2% (rënie prej 3.5% në tremujorin e kaluar) dhe arriti 5.652 pikë indeksi. Gjithashtu, qarkullimi i përgjithshëm në bursë shënoi rritje tremujore prej 27% (rënie prej 37.3% në tremujorin e kaluar), tërësisht si rezultat i rritjes së qarkullimit në bazë të transaksioneve në bllok, tregtimit të aksioneve dhe tregtimit të obligacioneve. Vlera e indeksit të obligacioneve (OMB) gjatë tremujorit u ul me 1 pikë indeksi dhe arrin në 125 pikë indeksi.



Në tremujorin e katërt të vitit 2022, indekset e bursave nga rajoni shënuan një rënie mesatare prej 9.2% (në rënie nga 5.9% në tremujorin paraprak). Një zhvendosje në rënie u regjistrua në shumicën e indekseve të bursave nga rajoni, me përjashtim të indekseve të Serbisë, ku u vu re një lëvizje e lehtë në rritje. Gjithashtu, indekset e ndryshueshmërisë së tregjeve të obligacioneve dhe aksioneve, përkatësisht indekset MOVE dhe VIKS⁶⁷ në baza ditore, shënuan një ndryshim divergjent, përkatësisht indeksi MOVE u rrit mesatarisht me 2.1% (rritje nga 10.1% në tremujorin paraprak), ndërkohë që VIKS u rrit mesatarisht për 1.5% (ulje prej 9.2% në tremujorin

⁶⁷ Indeksi MOVE (Merrill Lynch Option Volatility Estimate) tregon paqëndrueshmërinë e prejardhur (ose të nënkuptuar) të tregjeve amerikane për letrat shtetërore në vlerë. Indeksi VIX (Volatility Index) është ndërtuar bazuar në paqëndrueshmërinë e prejardhur të opsioneve në indeksin CP 500. Investitorët përdorin të dy indekset si tregues të kushteve dhe pritshmërive në lidhje me luhatshmërinë e tregjeve financiare. Një rrugë në rënie në indekse tregon një ulje të paqëndrueshmërisë.

paraprak). Lëvizjet e dy indekseve, të parë së bashku, tregojnë për pasigurinë ende të pranishme në tregjet botërore të kapitalit.



IV. Agregatët monetare dhe kreditore


Në tremujorin e katërt të vitit, u vu re një rritje e fortë tremujore e agregatit monetar më të gjerë M4. Kështu, niveli i ofertës monetare po normalizohet gradualisht, pas lëvizjeve të pafavorshme në gjysmën e parë të vitit nën ndikimin e krizës energjetike dhe pasigurisë me fillimin e agresionit ushtarak kundër Ukrainës. E analizuar nga pikëpamja strukturore, rritja rezulton nga rritja e të gjithë komponentëve të ofertës monetare, por më së shumti në parandepozituese (dhe më e theksuar në sektorin e familjeve). Nga aspekti valutor, depozitat në denarë dhe në valutë kanë shënuar rritje, ndërsa pjesëmarrja e depozitave në valutë në M4 në fund të tremujorit të fundit të vitit ka shënuar rënie të lehtë. Niveli më i lartë i depozitave është mbështetur edhe nga forcimi i mbështetjes kreditore të bankave gjatë kësaj periudhe. Kështu, aktiviteti kreditor në tremujorin e katërt shënoi rritje, me një rritje më të theksuar të kreditimit për sektorin e korporatave, e zakonshme për këtë periudhë të vitit. Rezultatet e Anketës së aktivitetit kreditor në tremujorin e katërt tregojnë për një neto-shtrëngim të kushteve të kreditimit për ndërmarrjet dhe familjet, me një netorritje të njëkohshme të kërkesës për kredi tek ndërmarrjet dhe një netorënie të kërkesës te familjet.

4.1. Agregatët monetare


Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2022, oferta më e gjerë monetare M4 shënoi një rritje tremujore prej 4.8%. Me këtë, niveli i këtij agregati monetar po normalizohet gradualisht, pas rënies në gjysmën e parë të vitit, shkaktuar nga kriza energjetike dhe nga pasiguria e lartë në kushtet e fillimit të luftës në Ukrainë. Rritja e shpejtë e ofertës monetare përfaqëson një lëvizje të zakonshme sezonale në tremujorin e fundit të vitit kur paguhen pagat, regreset e fund vitit dhe pensionet e familjeve, pjesërisht të plotësuar nga pagesat nga shteti për përballimin e krizës energjetike dhe mbështetjen e fermerëve me subvencione. Nga aspekti i strukturës, rritja kryesisht rezulton nga komponenti më likuid i ofertës monetare, përkatësisht nga rritja e parasë depozituese (kontributi pozitiv prej 2.3 p.p.), me rritjen e depozitave afatshkurte, depozitave afatgjate dhe paratë e gatshme në qarkullim (me një kontribut pozitiv përkatësisht 1.1 p.p., 0.9 p.p. dhe 0.5 p.p.). Sa i përket

strukturës valutore, depozitat në denarë (pa para depozituese) dhe depozitat në valutë kanë kontribut pozitiv përkatësisht prej 0,7 pp. dhe 1.3 p.p., në ndryshimin tremujor të ofertës monetare M4. Në përputhje me këto arritje, pjesëmarrja e depozitave në valutë në M4 në fund të tremujorit të katërt shënoi një rënie të lehtë dhe arriti në 40.0% (40.6% në fund të tremujorit paraprak). Në bazë vjetore, rritja e agregatit monetar M4 gjithashtu u përshpejtua dhe në fund të tremujorit të katërt të vitit 2022 ishte 5.1% (2.9% në fund të tremujorit paraprak).

Oferta monetare M4, struktura
(ndryshime tremujore, kontributet në pikë përqindje)



(ndryshime vjetore, kontributet në p.p.)




Burimi: BPRMV.

Totali i depozitave në sistemin financiar⁶⁸, në tremujorin e katërt të vitit 2022 shënuan një rritje prej 4.7% në bazë tremujore (rritje tremujore prej 3.0% në tremujorin paraprak). Nga pikëpamja sektoriale, rritja e depozitave rezulton nga rritja e depozitave të ndërmarrjeve dhe familjeve, me rritje më të ulët të depozitave të sektorëve të tjerë. Nga pikëpamja valutore, rritje më e theksuar vërehet te depozitat në denarë (përfshi edhe paratë depozituese), me një kontribut më të vogël pozitiv të depozitave në valutë, ndaj të cilave gjithashtu kontribuojnë masat e ndërmarrja nga Banka Popullore në lidhje me diferencimin e normave të rezervës së detyrueshme. Sipas strukturës së afatizimit, rritje vërehet në të dyja strukturat e afatizimit. Në bazë vjetore, rritja e totalit të depozitave në fund të tremujorit të katërt u përshpejtua dhe arriti në 4.9% (3.2% në fund të tremujorit paraprak).

⁶⁸ Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshitetor në banka dhe kursimoreve, mjetet e institucioneve të tjera financiare në llogaritë pranë BPRMV-së dhe mjetet e njësive të vetëqeverisjes lokale në llogaritë në BPRMV. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të NBRSM nga qershori 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në linkun e mëposhtëm:

http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspix.

**Depozita në total**

	2021				2022			
	Tr. 1	Tr. 2	Tr. 3	Tr. 4	Tr. 1	Tr. 2	Tr. 3	Tr. 4
ndryshime tremujore, në %								
Depozita në total	1.1	1.8	1.3	3.0	-2.9	0.2	3.0	4.7
kontributi në ndryshimin tremujor të totalit të depozitave, në p.p.								
Para të depozituara	0.5	1.2	0.5	1.5	-2.8	0.7	1.9	2.5
Depozita në denarë	-0.2	-0.7	-0.6	-1.2	-1.0	-0.9	0.3	0.7
Depozita në valuta të huaja	0.8	1.3	1.4	2.8	0.9	0.3	0.9	1.5
Depozita afatshkurtër	0.7	0.9	1.2	1.9	0.6	0.3	0.7	1.2
Depozita afatgjata	-0.1	-0.3	-0.4	-0.4	-0.7	-0.9	0.4	1.0
Amvisëritë	1.1	0.5	1.2	1.7	-0.9	1.4	1.2	2.0
Ndërmarrjet	-0.3	1.5	0.2	1.6	-2.2	-0.9	1.7	2.5
Sektorët tjerë	0.3	-0.2	-0.1	-0.3	0.2	-0.3	0.1	0.1

Burimi: BPRMV.

Depozitat e familjeve në tremujorin e katërt të vitit vazhduan të rriten, me një normë tremujore prej 3.1% (rritje nga 1.9% në tremujorin paraprak). Nga pikëpamja valutore, rritja në tërësi rezultoi nga rritja e depozitave në denarë (përfshirë paratë depozituese), ndërsa depozitat në valutë zvogëlohen. Për sa i përket strukturës afatizuese, depozitat afatgjata kanë shënuar rritje, ndërsa depozitat afatshkurtra kanë shënuar rënie. Në bazë vjetore, rritja e gjithsej depozitave të familjeve në fund të vitit 2022 është 5.8% (5.3% në fund të tremujorit paraprak).

Depozitat e ndërmarrjeve në tremujorin e katërt të vitit shënuan rritje tremujore të përshpejtuar prej 9.3% (6.3% në tremujorin paraprak). Nga këndvështrimi i strukturës valutore, rritja pothuajse në tërësi është rezultat i rritjes së depozitave në denarë (me përfshirjen e parave të depozituara), me një rritje më të vogël të depozitave në valutë. Nga pikëpamja e afatizimit, rritje më e theksuar është te depozitet afatshkurte, në krahasim me rritjen e depoziteve afatgjate. Në bazë vjetore, depozitat e ndërmarrjeve në fund të vitit 2022 janë më të larta për 3,7 % (0,4% në fund të tremujorit paraprak).

Depozita të amvisërive

	2021				2022			
	Tr.1	Tr. 2	Tr. 3	Tr. 4	Tr. 1	Tr. 2	Tr. 3	Tr. 4
ndryshime tremujore, në %								
Totali i depozitave të amvisërive	1.7	0.8	1.8	2.6	-1.4	2.1	1.9	3.1
kontributi në ndryshimin tremujor të totalit të depozitave, në p.p.								
Para të depozituara	0.6	0.5	0.9	0.5	-1.8	1.1	0.7	2.5
Depozita në denarë	0.1	-0.6	-0.4	-1.3	-1.4	-0.8	0.0	0.7
Depozita në valuta të huaja	1.0	0.9	1.3	3.3	1.8	1.8	1.2	-0.1
Depozita afatshkurtër	1.1	1.0	1.3	2.3	0.9	1.3	0.7	-0.6
Depozita afatgjata	-0.1	-0.7	-0.4	-0.2	-0.4	-0.3	0.5	1.2


Burimi: BPRMV.

Depozita të ndërmarrjeve

	2021				2022			
	Tr. 1	Tr. 2	Tr. 3	Tr. 4	Tr. 1	Tr. 2	Tr. 3	Tr. 4
ndryshime tremujore, në %								
Totali i depozitave të ndërmarrjeve	-0.9	5.6	0.8	5.8	-7.8	-3.2	6.3	9.3
kontributi në ndryshimin tremujor të totalit të depozitave, në p.p.								
Para të depozituara	-0.3	3.1	-0.4	5.1	-6.0	-0.4	4.7	3.2
Depozita në denarë	-0.3	-0.4	-0.8	-1.4	-0.4	-0.2	1.1	0.5
Depozita në valuta të huaja	-0.3	2.9	2.1	2.1	-1.4	-2.6	0.4	5.7
Depozita afatshkurtër	-0.7	1.3	1.6	1.7	-0.6	-0.8	0.9	5.4
Depozita afatgjata	0.1	1.2	-0.4	-0.9	-1.1	-2.0	0.7	0.7

Burimi: BPRMV.

Analiza e kthimeve⁶⁹ nga kursimet e reja tregon se në gusht normat e interesit për depozitat e reja të pranuar⁷⁰ në denarë dhe depozita e familjeve ishin përkatësisht 2,0% dhe 0,9%, (përkatësisht 1,7% dhe 0,6%, në shtator). Në këto kushte, diferenca e interesit ndërmjet kursimeve të reja në denarë dhe valutë të familjeve u zgjerua në muajin nëntor dhe arriti në 1,2 pikë përqindje. Në sektorin e korporatave, normat e interesit për depozitat e sapo pranuar në denarë dhe në valutë në nëntor përkatësisht ishte 2,0% dhe 0,6%, (përkatësisht 1,2% dhe 0,4%, në shtator). Zgjerimi i diferencave ndërmjet kursimeve të reja në denarë dhe në valutë është në përputhje me masat e ndërmarra nga Banka Popullore në kuadër të instrumentit të rezervës së detyrueshme, të cilat u mundësojnë bankave të ofrojnë interes më të favorshme për depozitat në denarë të klientëve të tyre. Sa i përket gjithsej depozitave të pranuar (denarë dhe valutë), normat e interesit për depozitat e ndërmarrjeve dhe familjeve në nëntor ishte përkatësisht 1.3% dhe 0.7%.



4.2. Aktivitetet kreditore

Aktiviteti kreditor i bankave në tremujorin e katërt të vitit u përshpejtua dhe shënoi një normë rritjeje tremujore prej 2.6%, që është një fenomen i zakonshëm sezonal në fund të vitit. Për sa i përket kushteve për miratimin e kredisë, sipas rezultateve të Anketës për aktivitetin kreditor, në tremujorin e katërt vërehet një neto-shtërëngim i kushteve të kreditimit, si për ndërmarrjet ashtu edhe për familjet. Megjithatë, përqindja më e madhe e bankave ende tregojnë kushte të pandryshuara të kredisë në të dy sektorët. Në të njëjtën kohë, është vërejtur një lëvizje e mëtejshme në rritje e kërkesës për kredi nga ana e ndërmarrjeve, por e ngadalësuar në krahasim me tremujorin paraprak. Në të njëjtën kohë, Anketa e aktivitetit kreditor tregon një neto-rënie më të theksuar të kërkesës të familjet. Për tremujorin e parë të vitit 2023, bankat presin një neto-shtërëngim të mëtejshëm të kushteve të kredisë në të dy sektorët, me një neto- rritje të pritshme të kërkesës për kredi në sektorin e ndërmarrjeve dhe një neto-rënie të lehtë të kërkesës për kredi totale për sektorin e familjeve.


⁶⁹ Të dhënat për normat e interesit janë në përputhje me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore nga qershori 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në linkun e mëposhtëm:
http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspix.

⁷⁰ Për sa i përket normave të interesit të depozitave të sapopranuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Paqëndrueshmëria e normave të interesit për depozitat e sapopranuara rrjedh nga fakti se ato lindin nga vëllimi i depozitave të reja (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

**Totali i kredive në sektorin privat**


	2021				2022			
	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4
ndryshime tremujore, në %								
Totali i kredive në sektorin privat	1.2	2.6	1.1	3.1	2.6	2.7	1.1	2.6
Kontributi në ndryshimin tremujor të totalit të kredive, në p.p.								
Kredi në denarë	0.7	1.8	0.7	2.4	1.3	1.1	-0.2	1.2
Kredi në valutë të huaj	0.5	0.8	0.4	0.7	1.3	1.6	1.4	1.4
Kredi afatshkurte	0.5	0.6	-0.4	0.8	1.4	0.5	-0.1	0.5
Kredi afatgjatë	0.5	1.9	1.5	2.6	1.3	2.0	1.2	2.5
Amvisëri	0.8	1.4	0.9	0.8	0.8	1.3	0.8	0.7
Ndërmarrje	0.4	1.1	0.3	2.3	1.8	1.3	0.3	1.9

Burimi: BPRMV-ja.

Kushtet e aprovimit të kredive

Burimi: anketa e aktivitetit kreditor, BPRMV

Analiza e strukturës sektoriale të kredisë për sektorin privat tregon se sektori i ndërmarrjeve ka kontributin më të madh pozitiv në rritjen tremujore, me një kontribut të moderuar pozitiv edhe nga sektori i familjeve. Nga pikëpamja valutore, rritja rezulton nga rritja e kredisë në valutë⁷¹ dhe ajo në denarë. Sa i përket strukturës së afatizimit, rritja tremujore e gjithsej kredive rezulton më së shumti nga rritja e kredive afatgjata, me një kontribut më të vogël pozitiv nga kreditë afatshkurtra. Njëkohësisht, pjesëmarrja e kërkesave të dyshimta dhe të kontestuar në totalin e kredive është ulur në krahasim me fundin e tremujorit të tretë dhe është 2.8%.



*Referohet pjesëmarrjes së kërkesave të dyshimta dhe kontestuese në kreditë totale të sektorit përkatës
Burimi: BPRMV

Në bazë vjetore, totali i kredisë në fund të vitit 2022 është më i lartë me 9.4% (9.9% në fund të tremujorit paraprak). Rritja vjetore e kredisë ka ardhur kryesisht nga rritja e kredisë për korporata, me një kontribut pozitiv të njëkohshëm të kredisë për familjet. Madje, pjesëmarrja e gjithsej kredive në totalin e depozitave është ulur dhe në fund të vitit 2022 është 84.6% (86.3% në fund të tremujorit paraprak).


⁷¹ Në të dhënat për kreditë në valutë janë përfshirë edhe kreditë në denarë me klauzolë valutore.

Rritja e kreditimit për sektorin "familje" ka vazhduar edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2022, por pak më e moderuar. Rritja e arritur tremujore prej 1.4% (ritje prej 1.5% në tremujorin paraprak) rezulton tërësisht nga rritja e kredisë banesore dhe konsumatore. Rezultatet e Anketës së aktivitetit kreditor për tremujorin e katërt të sektorit "familje" tregojnë për një neto-rënie të kërkesës për kredi dhe për një neto-shtrëngim të kushteve të kreditimit. Nga aspekti valutor, rritja pothuajse në tërësi rrjedh nga kreditë në valutë, me nivel të qëndrueshëm të kredive në denarë. E parë nga këndvështrimi i strukturës së afatizimit, rritja edhe më tej vijon të rezultojë nga kreditë afatgjata, me një rënie të lehtë të kredisë afatshkurtër. Në bazë vjetore, totali i kredisë për familjet në fund të tremujorit të katërt të vitit 2022 është më i lartë me 7.3% (7.6% në tremujorin paraprak).

Kreditë e shtëpive

	2021				2022			
	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4
ndryshime tremujore, në %								
Totali i kredive të shtëpive	1.6	2.8	1.7	1.6	1.6	2.6	1.5	1.4
kontributi i ndryshimit tremujor në kreditë totale, në p.p.								
Kredi në denarë	1.0	1.3	1.0	0.9	1.0	1.3	0.5	0.1
Kredi në deviza	0.5	1.4	0.6	0.6	0.6	1.3	1.0	1.3
Kredi me afat të shkurtër	0.2	0.1	0.0	-0.2	0.2	0.1	0.0	-0.2
Kredi me afat të gjatë	1.1	2.7	1.6	2.0	1.3	2.4	1.5	1.9

Burimi: BPRMV




Në tremujorin e katërt të vitit 2022 u forcua rritja e totalit të kredive të miratuara për sektorin e korporatave, e cila arriti në 3.9% në bazë tremujore. Sipas rezultateve të Anketës për aktivitetin kreditor për tremujorin e katërt, bankat tregojnë një neto-rritje të moderuar të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, me një neto-shtrëngim të kushteve të kreditimit, ndërsa si faktorë që ndikojnë më së shumti në rritjen e kërkesës për kredi, tregohen investimet në stoqe dhe kapital qarkullues, në ristrukturimin e borxhit dhe në një masë më të vogël në investime në mjete bazë. Nga aspekti valutor, rritja e gjithsej kredive për ndërmarrjet rezulton nga rritja në denarë dhe në masë më të vogël nga rritja e kredive në valutë (përfshirë kreditë me klauzolë në valutë). Sipas strukturës afatizuese, kreditë afatgjata janë në rritje, me një rritje të moderuar të kredisë afatshkurtër. Në nivel vjetor, rritja e gjithsej kredive për ndërmarrjet në fund të tremujorit të katërt ishte 11.5% (12.6% në fund të tremujorit paraprak).

Kreditë e ndërmarrjeve

	2021				2022			
	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4
ndryshime tremujore, në %								
Kredi totale të ndërmarrjeve	0.8	2.3	0.6	4.9	3.7	2.8	0.7	3.9
kontributi i ndryshimit tremujor në kreditë totale, në p.p.								
Kredi në denarë	0.2	2.3	0.3	4.1	1.7	0.9	-1.0	2.4
Kredi në deviza	0.6	0.1	0.2	0.8	2.0	1.8	1.8	1.5
Kredi me afat të shkurtër	0.9	1.1	-0.7	1.9	2.7	0.9	-0.3	1.3
Kredi me afat të gjatë	-0.1	1.1	1.5	3.3	1.3	1.5	1.0	3.1

Burimi: BPRMV

Sipas të dhënave për normat e interesit⁷² për kreditë e sapomiratuara⁷³ në muajin nëntor, normat e interesit për kreditë në denarë dhe në valutë për familjet ishin përkatësisht 5,2% dhe 3,6%, (përkatësisht 5,3% dhe 3,7% në shtator). Në këto kushte, diferenca e interesit ndërmjet kreditimit në denarë të ri dhe në valutë të familjeve arrin në 1,6 p.p. dhe nuk ka pasur ndryshime në krahasim me tremujorin paraprak. Tek ndërmarrjet, normat e interesit për kreditë e sapomiratuara në denarë dhe në valutë janë përkatësisht 4,7% dhe 4,1% (përkatësisht 4,0% dhe 3,3% në shtator), me çka edhe diferenca e interesit ndërmjet kreditimit të ri në denarë dhe valutë është ngushtuar pak në 0.6 p.p. Për sa i përket totalit të kredive të miratuara për sektorin privat, në fund të muajit nëntor normat e interesit për kreditë për ndërmarrjet dhe familjet arrin përkatësisht 3.7% dhe 5.0%.



V. Financat publike

Rritja vjetore e të hyrave buxhetore ka vijuar të ngadalësohet edhe në tremujorin e tretë dhe arriti në 10.1%. Rritja e të hyrave vazhdon të nxitet nga të hyrat më të larta tatimore. Rritja e shpenzimeve buxhetore u përshpejtua lehtë dhe arriti në 3.9%, nën ndikimin e rritjes së shpenzimeve rrjedhëse. Deficiti buxhetor është 0.7% e PBB-së dhe është më i ulët krahasuar me realizimin në të njëjtin tremujor të vitit të kaluar (1.2% e PBB-së). Në periudhën janar-nëntor 2022, deficiti buxhetor arrin në 2.8% të PBB-së, që përfaqëson rreth 56% të planifikuar për vitin 2022 dhe financohet kryesisht nga neto-huamarrjet e shtetit në tregjet e brendshme dhe të jashtme, ndërsa në akumulimi në të njëjtën kohë i depozitave shtetërore në Bankën Popullore. Borxhi i përgjithshëm publik në fund të tremujorit të tretë 2022 është 54.8% e PBB-së.



Në tremujorin e tretë të vitit 2022, të hyrat totale në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut⁷⁴ janë rritur për 10,1% në bazë vjetore (13,0% në tremujorin paraprak). Rritja e të hyrave buxhetore në nivel vjetor është rezultat i rritjes së flukseve hyrëse pothuajse në të gjitha kategoritë e

⁷² Të dhënat për normat e interesit janë në përputhje me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore nga qershori 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në linkun në vijim: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspix.

⁷³ Për sa i përket normave të interesit të kredive të reja të miratuara, duhet pasur parasysh se për to janë karakteristike lëvizjet e ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për kreditë e sapomiratuara rrjedh nga fakti se ato rezultojnë nga vëllimi i kredive të reja të miratuara (që mund të ndryshojnë në muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

⁷⁴ Buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve.

të hyrave buxhetore, kryesisht si pasojë e rritjes së të hyrave tatimore⁷⁵. Në fakt, të hyrat tatimore shënuan rritje vjetore prej 8.1% (me një kontribut pozitiv prej 4.8 p.p. në rritjen e të hyrave totale buxhetore). Kontributet⁷⁶ dhe të hyrat jotatimore kanë vijuar të rriten, krahasuar me periudhën paraprake, duke arritur një rritje vjetore prej 10.8% dhe 33.9% (me një kontribut pozitiv prej 3.4 p.p. dhe 2.2 p.p., në rritjen e të hyrave totale), ndërsa të hyrat e tjera⁷⁷ ishin më të ulëta për 7,0% me bazë vjetore (me një kontribut negativ prej 0.2 p.p. në rritjen e të hyrave totale).




Rritja e të hyrave totale tatimore prej 8.1% gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022 (16.4% në tremujorin paraprak) rezulton kryesisht nga të hyrat më të larta në taksat direkte (kontributi pozitiv prej 5.3 p.p.), si dhe pjesë më të vogël nga taksat indirekte (pozitive kontribut prej 1.7 p.p.). Tatimi mbi fitimin shënoi rritje më të lartë të tatimet e drejtpërdrejta, derisa të tatimet e indirekte rritje më të madhe është realizuar të të hyrat nga TVSH-ja.


⁷⁵ I përfshin gjithashtu llogaritë për të hyrat vetanake (LHV).

⁷⁶ Rritja e kontributeve është pjesërisht e lidhur me rritjen e pagës minimale neto në 18.000 denarë në mars 2022.

⁷⁷ Të hyrat e tjera përfshijnë të hyrat kapitale, donacionet e huaja dhe të hyrat nga huatë e paguara.




Burimi: Ministria e Financave




Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Rritja vjetore e totalit të shpenzimeve buxhetore u ngadalësua ndjeshëm në tremujorin e tretë të vitit 2022 dhe arriti në 3.9% (2.7% në tremujorin paraprak). Analizuar nga aspekti strukturor, rritja rezulton nga shpenzime rrjedhëse të cilët realizuan rritjeve vjetore prej 8.8%, njëkohësisht uljes së shpenzimeve kapitale për 38,2 në nivel vjetor. Rritja vjetore e shpenzimeve rrjedhëse më së shumti rezulton nga rritja e kategorisë "transfera"⁷⁸ dhe kryesisht rezulton nga pagimi i përkrahjes financiare të sektorit energjetik dhe subvencionet për bujqit.



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.



Burimi: Ministria e Financave

⁷⁸ Kategorija "transfera" i referohet shpenzimeve të pensioneve, shpenzimeve të mbrojtjes sociale, shpenzimeve të mbrojtjes shëndetësore dhe transfera të tjera (kryesisht subvencione).



Deficiti buxhetor në tremujorin e tretë të vitit 2022 arriti në 5.713 milionë denarë, ose 0,7% nga PBB⁷⁹, që paraqet arritje më të ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (deficit prej 1,2% nga PBB). Deficiti i arritur u financua plotësisht nëpërmjet neto-huazimit në tregun vendas, përdorimit të depozitave të shtetit në Bankën Popullore dhe zhvlerësimit neto të tregut të jashtëm.

BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (Buxheti Qëndror dhe Buxheti i Fondeve)

	2022								2022							
	Buxheti për vitin 2022	Ribalancimi i buxhetit për vitin 2022	Shpërndarja e I - rë e buxhetit për vitin 2022	Shpërndarja e II - të e buxhetit për vitin 2022	Tr.1	Tr.2	Tr.3	jan. - nën.	Tr.1	Tr.2	Tr.3	janar - nëntor				
									Ndryshimi me vjetorë, në %	Kontributi në ndryshimi min vjetor,	Ndryshimi me vjetorë, në %	Kontributi në ndryshimi min vjetor,	Ndryshimi me vjetorë, në %	Kontributi në ndryshimi min vjetor,	Ndryshimi me vjetorë, në %	Kontributi në ndryshimi min vjetor,
TË HYRA TOTALE	238,899	245,758	245,758	245,758	57,106	59,208	62,200	219,316	16.8	16.8	13.0	13.0	10.1	10.1	11.3	11.3
Të hyrat tatimore dhe kontributet	210,829	221,770	221,770	221,770	52,314	53,787	55,628	198,702	18.1	16.4	13.9	12.5	9.0	8.2	12.1	10.9
Tatimet*	136,458	143,173	143,173	143,173	35,013	34,713	36,002	129,712	25.0	14.3	16.4	9.3	8.1	4.8	13.9	8.0
Kontribute	74,371	78,597	78,597	78,597	17,301	19,074	19,626	68,990	6.1	2.0	9.5	3.1	10.8	3.4	9.0	2.9
Të hyra jotatimore	19,171	17,043	17,043	17,043	3,681	4,068	4,894	15,579	12.4	0.8	26.9	1.6	33.9	2.2	26.6	1.7
Të hyra kapitale	3,330	2,180	2,180	2,180	281	507	971	2,214	44.8	0.2	113.9	0.5	-20.9	-0.5	25.1	0.2
Donacione nga jasht	5,570	4,765	4,765	4,765	830	846	707	2,821	-25.8	-0.6	-50.8	-1.7	22.3	0.2	-50.2	-1.4
SHPENZIME TOTALE	272,428	288,493	288,493	288,493	63,775	62,883	67,913	243,141	11.4	11.4	2.7	2.7	3.9	3.9	7.1	7.1
Shpenzime rrjedhëse	234,192	256,384	255,808	255,906	58,858	59,268	63,722	223,563	13.6	12.3	1.1	1.0	8.8	7.9	6.8	6.2
Shpenzime kapitale	38,236	32,109	32,685	32,587	4,917	3,615	4,191	19,578	-9.9	-0.9	40.1	1.7	-38.2	-4.0	11.3	0.9
DEFICITI / SUFICITI BUXHETOR	-33,529	-42,736	-42,736	-42,736	-6,669	-3,675	-5,713	-23,825								
Financim	33,529	42,736	42,736	42,736	6,669	3,675	5,713	23,825								
Të hyrat	45,103	54,513	54,513	54,513	7,714	6,853	7,191	31,416								
Të hyra tjera	500	500	500	500	106	312	168	835								
Kredi të huaja	21,269	65,524	65,524	65,524	844	638	145	24,678								
Depozita	-3,296	-38,141	-38,141	-38,141	4,505	4,859	-1,446	-6,952								
Bonot shtetërore	26,620	26,620	26,620	26,620	2,259	1,044	8,324	12,855								
Shitja e aksioneve	10	10	10	10	0	0	0	0								
Të dalat	11,574	11,777	11,777	11,777	1,045	3,178	1,478	7,591								
Shlyerja e kryeqjellës	11,574	11,777	11,777	11,777	1,045	3,178	1,478	7,591								
Borxhi i jashtëm	6,045	6,235	6,235	6,235	1,045	1,853	993	4,969								
Borxhi i brendshëm	5,529	5,542	5,542	5,542	0	1,325	485	2,622								
Të dalat tjera																


* Përfshin të hyra tatimore (SSP)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ilogaritetit e BPRMV-së.

Në periudhën janar – nëntor 2022, të ardhurat totale buxhetore janë më të larta me 11,3% me bazë vjetore. Pjesa më e madhe e kësaj rritje, ose 8.0 p.p., rezulton nga arritje më të mira në të hyrat tatimore, ndërsa kontributet, të hyrat jotatimore dhe të hyrat kapitale kanë një kontribut më të vogël pozitiv. Në të njëjtën kohë, shpenzimet buxhetore janë më të larta për 7.1% në bazë vjetore, që është tërësisht rezultat i rritjes së shpenzimeve rrjedhëse⁸⁰, me rënie të shpenzimeve kapitale. Në periudhën e analizuar deficiti buxhetor arrin në 23.825 milionë denarë ose 2.8% të BPB-së, që paraqet 56% të deficitit të planifikuar për vitin 2022. Financimi i deficitit buxhetor në këtë periudhë është realizuar më së shumti nëpërmjet përdorimit të depozitave të shtetit në Bankën Popullore dhe huamarrjes neto të shtetit në tregun e brendshëm dhe jashtëm.

⁷⁹ Në kuadër të analizës, projeksionet e prillit të Bankës Popullore janë të përdorura për PBB-në nominale për vitin 2022.

⁸⁰ Rritja vjen më së shumti nga nënzëri transferata, e cila është rritur për shkak të shpenzimeve më të larta të pensioneve. Shpenzimet e pensioneve janë rritur për shkak të një rritjeje prej 2.9% në janar 2022, në bazë të harmonizimit të pensioneve me rritjen e shpenzimeve të jetesës. Gjithashtu, në periudhën prill-qershor, për secilin pensionist është paguar nga 1.000 denarë ndihmë në përputhje me paketën e masave ekonomike nga 9 mars 2022.



Borxhi publik total⁸¹ në fund të tremujorit të tretë të vitit 2022 është 54.8% e PBB-së (51.8% e PBB-së në fund të tremujorit paraprak), që paraqet një rritje të vogël tremujore prej 3.0 p.p. nga PBB. Në të njëjtën kohë, borxhi publik i jashtëm dhe i brendshëm janë relativisht të qëndrueshme dhe arrijnë në 35.8% dhe 19.0% të PBB-së. Nga aspekti i strukturës së borxhit, borxhi total shtetëror⁸² borxhi i ndërmarrjeve publike (të garantuara dhe të pagarantuar)⁸³ arrijnë në 46.6% dhe 8.2% të PBB-së. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, borxhi total publik në fund të tremujorit të tretë të vitit 2022 është më i ulët me 4.6 p.p. të PBB-së⁸⁴.

⁸¹ Borxhi publik definohet me Ligjin për Borxhin Publik ("Gazeta Zyrtare e RM" numër 62/05, 88/08, 35/11, 139/14 dhe 98/19) sipas të cilit përfaqëson shumën e borxhi shtetëror dhe borxhi i ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë në pronësi të plotë ose të përgjithshme të shtetit ose komunave; komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit.

⁸² Borxhi shtetëror definohet si shuma e borxheve të qeverisë qendrore, fondeve publike dhe komunave.

⁸³ Në përputhje me ndryshimet në Ligjin për borxhin publik nga maji 2019, borxhi i pagarrantuar i ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit llogaritet në borxhin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05, 88/08, 35/11, 139/14 dhe 98/19).

⁸⁴ Në kuadër të analizës janë përdorur projeksionet e prillit të Bankës Popullore për PBB-në nominale për vitin 2022. Diferenca më e madhe midis PBB-së nominale të realizuar për vitin 2021 dhe shumës së parashikuar të PBB-së nominale për vitin 2022 është reflektuar edhe në treguesit relativë të borxhit publik.